# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5680
E shtunë, 19 janar 2019
çmimi 0.40 €


## KMDLNj-ja kërkon trajtim të barabartë për avokatët e Gjykatës Speciale
FAQE 3




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


### AKTUALE

**PUTINI NË BEOGRAD, ASGJË E RE NGA ALEANCA E VJETËR** F. 11



Prof. Lisen BASHKURTI

**HARADINAJ PRET NË TAKIM 120 STUDENTË NGA VJENA DHE VENEDIKU** F. 2

**MË 30 JANAR MBAHET SEANCA E PARË E KUVENDIT PËR SESIONIN PRANVEROR** F. 2

FLET PËR "EPOKËN E RE", LULZIM RAFUNA FAQE 4-5

# Angazhimi i dy qeverive eliminoi burokracinë



Lulzim Rafuna, këshilltar për tatime dhe doganë i kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se bashkëpunimi ekonomik Shqipëri - Kosovë asnjëherë nuk ka qenë më i mirë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Rafuna ka theksuar se të dyja qeveritë kanë bërë shumë për ta eliminuar burokracinë, megjithatë ai thotë se nuk duhet të jemi të kënaqur me kaq, pasi mund të bëhet më shumë. Ai ka thënë se hapja e Zyrës Doganore e Doganës së Kosovës në portin e Durrësit do t'i ndihmojë shumë tregtisë mes dy vendeve dhe më gjerë. Rafuna ka thënë se marrja e vendimeve nga të dy shtetet dhe zbatimi i marrëveshjeve nuk ka qenë asnjëherë më i madh dhe më i shpejtë

### EKONOMI

**BERZH-I KONFIRMON PËRKRAHJEN PËR SEKTORIN PRIVAT DHE PUBLIK** F. 9

**MTI-ja KËRKON RESPEKTIMIN E URDHËRESËS PËR VENDOSJEN E ÇMIMEVE TË DERIVATEVE** F. 9



# Kosova nuk tërhiqet nga taksa 100 % ndaj mallrave serbe




Udhëheqësit më të lartë të shtetit të Kosovës kanë bërë me dije të premten se nuk do të hiqet taksa ndaj mallrave serbe pavarësisht prej kërkesës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA-së) për ta pezulluar taksën. Kryeparlamentari Kadri Veseli dhe kryeministri Ramush Haradinaj kanë thënë se taksa nuk do t'i dëmtojë raportet e mira Kosovë - ShBA FAQE 4-5



## SBAShK-u, apel MAShT-it dhe DKA-ve: Lërini përpjekjet e kota për ta thyer grevën
FAQE 6

### KULTURË

**DALLGËT E DHIMBSHME TË NJË DETI VARRESH** F. 6

Nga Namik Selmani, *shkrimtar*

### SPORT

**KELMENDI: KOSOVA MUND TA KALOJË NJË RAUND** F. 20


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

# Presidenti Meta dekreton Ramën ministër të Jashtëm

Presidenti Ilir Meta njoftoi se e ka firmosur emërimin e kryeministrit Edi Rama edhe në postin e ministrit të Jashtëm, duke e vlerësuar rast të veçantë "që nuk parashikohet dhe as ndalohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë"



TIRANË, 18 JANAR - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka dekretuar kryeministrin shqiptar, Edi Rama, në postin e ministrit të Jashtëm, duke e vlerësuar rast të veçantë "që nuk parashikohet dhe as ndalohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë".
Propozimi i Ramës për ministër për Punë të Jashtme dhe Evropë erdhi pasi presidenti Meta refuzoi ta dekretojë ministrin e emëruar, Gent Cakaj, në këtë pozitë. Presidenti nëpërmjet një letre drejtuar kryeministrit kishte thënë se "profili i Gent Cakajt, i propozuar për postin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, ka mungesë të qartë të përvojës politike, diplomatike, administrative, shtetërore, në secilin element dhe në tërësi".
Pas këtij vendimi, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka bërë me dije se ai vetë do ta ushtrojë detyrën e shefit të diplomacisë së vendit në mungesë të një ministri të Jashtëm. "Në shqyrtimin e këtij propozimi presidenti i Republikës, në cilësinë e Kreut të Shtetit, ka mbajtur në konsideratë edhe rëndësinë e evitimit të çdo mundësie për krijimin e një krize institucionale, e cila do ta dëmtonte pozitën e Republikës së Shqipërisë në marrëdhëniet ndërkombëtare", tha Tedi Blushi, zëdhënës në Presidencën e Shqipërisë.
Presidenti Meta deri sot nuk kishte firmosur as shkarkimin e ish-ministrit të Jashtëm, Ditmir Bushati. Mosdekretimi i shkarkimit dhe emërimit kishte shkaktuar një ngërç mes dy institucioneve të larta dhe përplasje fjalësh mes dy krerëve të shtetit. "Në shqyrtimin e këtij propozimi presidenti i Republikës, në cilësinë e Kreut të Shtetit, ka mbajtur në konsideratë edhe rëndësinë e evitimit të çdo mundësie për krijimin e një krize institucionale, e cila do të dëmtonte pozitën e Republikës së Shqipërisë në marrëdhëniet ndërkombëtare", tha Blushi.
Modeli i kryeministrit që të ushtrojë edhe detyrën e ministrit të Jashtëm është bërë edhe në Greqi, ku kryeministri grek Alexis Tsipras, pas largimit të Nikoz Kotzias si ministër i Jashtëm, mori përsipër edhe këtë post.

## Kryemadhi: Bëhuni gati për revolucion

TIRANË, 18 JANAR - Lëvizja Socialiste për Integrim ka mbledhur të premten Komitetin Drejtues Kombëtar me fokus organizimi i partisë në kuadër të aksionit politik që ka ndërmarrë së fundmi opozita pas tensionimeve në seancën e jashtëzakonshme plenare ku Kuvendi miratoi pa debat ndryshimet e më shumë se gjysmës së anëtarëve të kabinetit qeveritar. Gjatë fjalës së saj, kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, u bëri apel shqiptarëve që t'u bashkohen protestave të opozitës për të bërë të mundur largimin një orë e më parë të kësaj qeverie që ka marrë peng vendin. Monika Kryemadhi iu ka bërë thirrje strukturave në qarqe të mos presin më, por të bëhen gati për revolucion. "Opozita e vendosur për rrëzimin e Edi Ramës. Rrëzimi i Edi Ramës, rikthen 400 mijë shqiptarët e larguar nga vendi. Rrëzimi i Edi Rames do të thotë ulje taksash dhe konsolidim të ekonomisë shqiptare", tha kryetarja e LSI-së.




Në këtë takim, Kryemadhi edhe në vijim të vendimit të marrë si opozitë e bashkuar kërkoi mobilizim nga anëtarët e komitetit drejtues të qarqeve. Kryetarja e LSI-së tha se të rrëzosh dhe të largosh këtë kryeministër është të krijosh shanse të barabarta për të gjithë shqiptarët. "Jemi të vendosur më shumë se kurrë për të ardhmen e fëmijëve të shqiptarëve. Jemi të vendosur për të kthyer Shqipërinë në shtëpinë e shqiptarëve. Do e vendosim aksionin politik aty ku duhet dhe t'u kthejmë dinjitetin shqiptarëve. Komisionari Hahn kërkon hapur dhe ka nxjerrë kush është problemi i zvarritjes së dialogut politik dhe i reformave në Shqipëri dhe i kërkoi hapur Ramës. Dua që të bëj një sqarim të thjeshtë për sa i përket anëtarëve të komiteti drejtues nga qarqe jashtë Tiranës, nuk ka më pritje, bëhuni gati për revolucion, protesta, revolta koncerte, çfarë të doni ju. Nuk ka më kohë për të pritur", deklaroi Kryemadhi.

## Plani i ministres Shahini për t'i liruar studentët nga ngujimi

TIRANË, 18 JANAR - Ministrja e re e Ministrisë së Arsimit në Shqipëri, Besa Shahini, ka zbuluar në një emision të "Top Channel"-it planin për t'i dhënë fund ngujimit të studentëve nëpër fakultete. "Kam në plan që të shkoj në të gjitha fakultetet dhe të flas me studentët që po protestojnë ende brenda institucioneve", tha Shahini.
Ministrja theksoi se ajo i ka pyetur studentët se cilat janë aspektet e Ligjit të arsimit të lartë që kanë shkaktuar probleme dhe cilat pjesë do të shkaktojnë probleme pas 10 viteve, por, sipas saj, në këtë pikë nuk ka marrë përgjigje konkrete. "Pakti nuk ka nevojë të miratohet në Parlament. Ajo që synojmë të bëjmë është t'i shohim mundësitë tona dhe të universitetit për të përmirësuar sistemin. Përmes diskutimit duam të arrijmë aty ku duhet. 8 kërkesa kishin studentët. Tarifat ishin pjesa kryesore dhe morëm 4 vendime që e adresojnë në forma të ndryshme tarifën. Në masën më të madhe përgjysmohet tarifa. Kostoja e kësaj, përfshi bursat, kushton 1,8 miliard lekë dhe përfitojnë mbi 90 mijë studentë", tha Shahini.



## Të hënën nis Kuvendi, opozita ka paralajmëruar protesta



Tiranë, 18 janar - Ditën e hënë në orën 17:00 do të hapet zyrtarisht sesioni IV i Legjislaturës IX të Kuvendit të Shqipërisë. Njoftimi është bërë në faqen zyrtare të Kuvendit, ku është bërë publik edhe rendi i ditës. Dy nga pikat janë dekretet e presidentit Ilir Meta për shkarkimin e Ditmir Bushatit ministër i Jashtëm dhe miratimi i kryeministrit Edi Rama edhe ministër të Jashtëm. Nga ana tjetër nuk dihet nëse opozita do jetë e pranishme në seancë. Por opozita e bashkuar me një vendim të para dy ditësh ka deklaruar se do të nisë sezonin e protestave deri në rrëzimin e qeverisë.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# KMDLNj-ja kërkon trajtim të barabartë për avokatët e Gjykatës Speciale



Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka kërkuar trajtim të barabartë për avokatët vendorë dhe ndërkombëtarë që do të jenë të përfshirë në proceset gjyqësore të Gjykatës Speciale. Kjo kërkesë ka ardhur pas raportimeve se një avokat ndërkombëtar ka kërkuar pagesë ditore në vlerë mbi 2 000 euro. KMDLN-ja thotë se nëse ndonjë i akuzuar dëshiron të angazhojë avokat ndërkombëtar duhet të llogarisë në shumën që Qeveria e ndanë për avokatët nga Kosova. Dhe, sipas këtij këshilli, çdo shumë që e kalon limitin e caktuar duhet të kompensohet nga i akuzuari

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 18 JANAR - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) nëpërmjet një deklarate për medie të premten ka kërkuar që të ketë trajtim të barabartë të avokatëve vendorë dhe atyre ndërkombëtarë që do të jenë të përfshirë në proceset gjyqësore të Gjykatës Speciale. Sipas këtij institucioni, kohët e fundit në media po përflitet se avokatët ndërkombëtarë kërkojnë mëditje të papërballueshme për buxhetin e Kosovës dhe jonormale për standardin tonë. Mirëpo KMDLN-ja thotë se nëse ndonjë i akuzuar dëshiron të angazhojë avokat ndërkombëtar duhet të llogarisë në shumën që Qeveria e ndanë për avokatët nga Kosova. Dhe, sipas këtij këshilli, çdo shumë që e kalon limitin e caktuar nga Qeveria duhet të kompensohet nga i akuzuari. "Si shembull, KMDLNj-ja thekson se, sipas medieve, i angazhuari për mbrojtje të Sami Lushtakut, Najs, paska kërkuar 2 200 euro pagesë për një ditë. Sigurisht se kësi tarife, por edhe më të larta, do të kërkojnë edhe avokatët e tjerë ndërkombëtarë. Qeveria e Kosovës, së paku sa është informuar KMDLNj-ja, ende nuk ka caktuar shumën për avokatët nga Kosova e që janë në listë për përfaqësim juridik dhe mbrojtje të të akuzuarve të mundshëm para kësaj Gjykate. Në këtë kontekst, KMDLNj-ja kërkon trajtim të barabartë dhe jodiskriminues të avokatëve nga Kosova dhe atyre ndërkombëtarë sepse e bëjnë punën e njëjtë. Nëse ndonjë i akuzuar shpreh dëshirë të angazhojë ndonjë avokat që ka emër ndërkombëtar apo kompani avokatie, ai duhet të llogarisë në shumën që qeveria e ndanë për avokatët nga Kosova ndërsa, çdo shumë që e kalon limitin e caktuar nga Qeveria duhet të kompensohet nga vetë i akuzuari. Qeveria nuk ka për detyrim të ndajë mjete për një mbrojtje të kushtueshme për disa të akuzuar dhe mjete të tjera që parashihen sipas vendimit të Qeverisë për të akuzuar të tjerë", është thënë në këtë deklaratë.

Çdo diskriminim në këtë fushë, për KMDLNj-në është e papranueshme dhe do të denoncohet publikisht si shkelje e të drejtave të njeriut dhe shpërdorim i parasë publike. Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) e konsideron simbolike shumën që e ka ndarë Qeveria e Kosovës prej 1.5 milionë eurosh për ta paguar mbrojtjen e të akuzuarve të mundshëm të Kosovës nga Gjykata Speciale si dhe mbulimin e të gjitha shpenzimeve që ndërlidhen me procesin gjyqësor për familjarët e ngushtë të atyre që do të gjykohen. "Ndonëse ka zëra dhe qëndrime që e kundërshtojnë këtë qëndrim të Qeverisë së Kosovës, KMDLNj-ja e ka përkrahur fuqishëm këtë vendim, duke konsideruar se ky është detyrim i Qeverisë së Kosovës aq më parë, që në rrethana të ngjashme, edhe qeveritë e Kroacisë, Bosnjës, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut kanë ndarë fonde për qytetarët e këtyre shteteve dhe familjarët e tyre, madje në shuma shumë më të larta. Qytetarët e Kosovës pa vullnetin e tyre po dërgohen në një shtet tjetër dhe po përballen me një aparat hetues, prokurorial, gjyqësor, administrativ e tjera, që nuk janë nga Kosova, nuk kanë të bëjnë asgjë më Kosovën, nuk e flasin asnjë gjuhë që flitet në Kosovë dhe nuk kanë asnjë ngjashmëri apo përputhshmëri me traditën apo kulturën e Kosovës", është thënë më tutje në deklaratën e KMDLNj-së. Sipas KMDLNj-së, familjarët e të akuzuarve, atyre që gjykohen apo të të dënuarve eventualë, nuk mund të privohen nga e drejta elementare e njeriut që të interesohen, të marrin pjesë në gjykim apo t'i vizitojnë të dënuarit e mundshëm e për të cilat duhen mjete të konsiderueshme materiale e që shumica e familjarëve nuk i kanë. "Me të gjitha ligjet, deklaratat dhe konventat ndërkombëtare dhe kombëtare për të drejtat e njeriut për persona të privuar nga liria parashihet që personat e dënuar ta mbajnë dënimin sa më afër vendit ku jetojnë, për të qenë afër familjes dhe për ta ruajtur familjen duke kursyer shpenzime të mëdha materiale. Nëse dënoheni për një vepër të caktuar penale kjo nuk nënkupton se privimi nga liria është mohim i të gjitha të drejtave të njeriut. KMDLNj, për shkak të trajtimit diskriminues të qytetarëve të Kosovës, që nga çasti kur intervistohen e deri te vuajtja e dënimit pati propozuar që barra e të gjitha shpenzimeve, si mbrojtja juridike, të gjitha shpenzimet për familjarët e ngushtë si dhe monitorimi i respektimit të drejtave të personave të privuar nga liria të mbulohen nga buxheti i Gjykatës Speciale sepse janë krijuar rrethana të veçanta për qytetarë e Kosovës, subjekt potencialë të kësaj gjykate e që rast të ngjashëm nuk e kemi në praktikat e deritashme juridike. Pasi Gjykata Speciale nuk i kompenson këto shpenzime, KMDLNj nuk e ka asnjë dilemë se këtë duhet ta bëjë shteti i Kosovës sepse e ka detyrim", është theksuar në reagimin e KMDLNj-së.

Presioni ndërkombëtar për heqjen e taksës ndaj mallrave serbe ende nuk ka dhënë ndonjë rezultat tek institucionet e

# Kosova nuk tërhiqet nga taksa




Udhëheqësit më të lartë të shtetit të Kosovës kanë bërë me dije të premten se nuk do të hiqet taksa ndaj mallrave serbe pavarësisht prej kërkesës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) për ta pezulluar taksën. Kryeparlamentari Kadri Veseli dhe kryeministri Ramush Haradinaj kanë thënë se taksa nuk do t'i dëmtojë raportet e mira Kosovë - ShBA

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 18 JANAR - Pavarësisht prej kërkesës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) për heqjen e taksës 100 për mallrat serbe, liderët institucionalë të Kosovës nuk kanë lëvizur nga qëndrimi i tyre. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, dhe kryeministri Ramush Haradinaj kanë deklaruar se kjo taksë nuk rrezikon partneritetin me ShBA-në.
Kryeparlamentari Veseli, pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, ka thënë të premten se partneri kryesor i Kosovës është ShBA-ja, duke shtuar se këtë partneritet do ta ruajnë. "Taksa 100 për qind i ka bërë mirë Serbisë. Ajo ka qenë një reaksion i agresivitetit të Serbisë ndaj Kosovës. Për vetë faktin se Serbia për një kohë të gjatë ka qenë tepër agresive dhe nuk e ka respektuar Kosovën. Kemi për të bërë që Serbia çdo ditë ta respektojë shtetin tonë të pavarur dhe sovran. Asnjë veprim yni nuk është drejtuar kundër asnjë qytetari të asnjë komuniteti etnik. Në të njëjtin kohë, të jeni të sigurt se në të gjithë jetën time politike ka veç një partner për vendin tim. Kjo është ShBA-ja. Nuk do ta dëmtojmë këtë partneritet, as nuk do të lejojmë që të na dëmtojnë", ka thënë Veseli. Ai ka vlerësuar se Kosova është krenare që ka një partner si ShBA-ja. Sipas Veselit, mesazhet që vijnë nga ky shtet për Kosovën janë mesazhe të miqësisë. "Ne jemi vend perëndimor dhe jemi krenar që kemi raporte të shkëlqyeshme me ShBA-në. Letra e presidentit Trump, qëndrimet e ambasadorit të ShBA-së, janë mesazhe që i marrim shumë seriozisht dhe janë mesazhe të miqësisë sonë të përbashkët. Partneriteti me ShBA-në do të jetë i përjetshëm", ka deklaruar Veseli. Ai ka mohuar se ka kërkesë të drejtpërdrejtë nga ShBA-ja që të hiqet taksa. "Ka një kërkesë që t'i jepet perspektivë dhe fuqi Kosovës në procesin e dialogut, por nuk ka kërkesë që të hiqet taksa. Ka kërkesë që t'i jepet mundësi procesit të dialogut në të cilën do të veprojmë bashkërisht. Shqetësimet e Amerikës do të jenë edhe të tonat", ka deklaruar Veseli, duke shtuar se Kosova ka partneritetet me ShBA-në dhe nuk do ta dëmtojë atë.
Edhe kryeministri Ramush Haradinaj gjatë një tubimi me strukturat e partisë së vet në Mitrovicë ka deklaruar se Kosova do ta vazhdojë taksën. "Është lajm i mirë taksa ndaj produkteve të Serbisë. Ne vendosëm taksë 10 për qind për t'ua tërhequr vërejtjen, por nuk ndryshoi gjendja. Tani taksa është 100 për qind. Të gjithë e dimë që në botën e re interesi ekonomik po i tërheq edhe interesat e tjera", ka thënë ai, duke shtuar se taksa tani gëzon një përkrahje të madhe popullore. "Dikush po thotë mos e lidhni me njohjen, por ne e dimë se njohja është gjë shumë e vogël për Serbinë në krahasim me tregun e Kosovës. Taksa tani ka një përkrahje të madhe popullore", është shprehur Haradinaj.
Për taksën të premten ka folur edhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, i cili në një konferencë për medie i ka bëri thirrje Bashkimit Evropian që të ndikojë më fuqishëm te Prishtina për taksën. Sipas tij, taksa duhet të hiqet sepse është e rëndësishme që të vazhdojë dialogu për normalizimin e marrëdhënieve në mes të dy vendeve. "E lus BE-në që kërkesat e saj ndaj

## Më 30 janar mbahet seanca e parë e Kuvendit për sesionin pranveror

PRISHTINË, 18 JANAR (ER) - Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës, e drejtuar nga Kadri Veseli, kryetar, ka zhvilluar të premten mbledhjen e parë për vitin 2019, duke përcaktuar seancën e parë për këtë sesion. Më 30 janar 2019, në orën 10:00, Kuvendi do të mblidhet në seancë të rregullt, në të cilën do të shqyrtojë një varg projektligjesh dhe çështjesh të tjera. Po ashtu, do të ketë edhe votime të pikave nga seancat e kaluara. Më pas pritet të zhvillohen dy interpelanca dhe tri debate parlamentare. Kryesia në mbledhjen e së premtes ka shqyrtuar edhe çështje të tjera nga fushëveprimtaria e saj. Kështu, kryesia ngarkoi komisionet parlamentare që t'i hartojnë planet e punës dhe në bashkërendim me programin legjislativ të Qeverisë, të hartohet plani legjislativ i Kuvendit për këtë vit. Peticioni i qytetarëve të Komunës së Mitrovicës Jugore për nismën legjislative për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-041 për Kufijtë Administrativë të Komunave u procedua për shqyrtim në komisionin përkatës parlamentar.



e Kosovës

# 100 % ndaj mallrave serbe




palës shqiptare të jenë më të qarta dhe më specifike, jo sepse do t'u gëzohesha atyre, por mendoj se e kemi shumë të rëndësishme të vazhdojmë të bisedojmë për serbët në Kosovë dhe për neve", ka thënë Vuçiq. Ai ka deklaruar se ka dëgjuar nga Prishtina se qëllim kryesor i taksës është t'i sjellë Serbisë dëm ekonomik dhe politik. "Nuk mendoj se disa njerëz, që e konsiderojnë veten burrështetas, kanë qasje serioze derisa bëjnë politikë për t'i bërë dëm dikujt", është shprehur Vuçiq.
Qeveria e Kosovës më 6 nëntor të vitit të kaluar kishte vendosur fillimisht taksë doganore 10 për qind për produktet e importuara me origjinë nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina. Kjo taksë doganore u ngre në 100 për qind më 21 nëntor. Përveç kësaj, më 28 dhjetor Qeveria e Kosovës ka marrë vendim që të vendosë taksë doganore 100 për qind edhe për produktet e importuara nga brendet ndërkombëtare që prodhohen në Serbi dhe Bosnje e Hercegovinë. Këto vendime të Qeverisë së Kosovës kanë ardhur si kundërpërgjigje të ofensivës diplomatike serbe kundër Kosovës në arenën ndërkombëtare, e cila ka kulmuar me mosanëtarësimin e Kosovës në Interpol.

# Shërbyesit civilë të komunave, të pakënaqur me Projektligjin për paga



Mitrovicë, 18 janar (ER) - Sindikata e të Punësuarve të Komunës së Mitrovicës, në bashkëpunim me sindikatat e disa komunave të tjera, janë shprehur të pakënaqur me Projektligjin për paga për shërbyesit civilë. Në një konferencë për media ata kanë vlerësuar se shërbyesit civilë të komunave janë të diskriminuar me këtë ligj, duke paralajmëruar grevë nëse nuk rritet koeficienti i tyre.
Kryetari i Sindikatës së të Punësuarve në Komunë të Mitrovicës, Mehmet Bajrami, ka thënë se kërkojnë një qasje më të dinjitetshme për punëtorët e nivelit komunal, pasi që janë kategoria më e përbuzur dhe e diskriminuar sa i përket Projektligjit për paga. Ai ka deklaruar se kërkojnë rritjen e koeficientit për shërbyesit civilë në nivel komunal për 30 për qind, duke përfshirë çdo nivel. Sipas Bajramit, ata janë të diskriminuar me koeficientin që kanë tash derisa ka shtuar se zyrtarëve të tjerë komunalë me atë koeficient që është paraparë me Projektligjin për paga pritet t'u ulet paga deri në 40 për qind.
Përfaqësuesit e Sindikatës së të Punësuarve Komunalë i kanë bërë thirrje komisionit përkatës që ta ndryshojë koeficientin deri më 21 janar. Sipas tyre, nëse një gjë e tillë nuk ndodh, ata do të marrin vendim për hyrje në grevë dhe se grevës pritet t'i bashkohen edhe disa komuna të tjera. "Ne ia kemi drejtuar nivelit qendror kërkesën me shkrim dy herë dhe kemi qenë pjesëmarrës edhe në takimet në Kuvend të Kosovës, konkretisht Komisionin Parlamentar dhe kemi pritur mirëkuptim nga Komisioni për nivelimin e koeficienteve të shërbyesve civilë me kategoritë e tjera, por kemi marrë përgjigje negative nga të njëjtit, me arsyetimin se kërkesa jonë nuk ka qenë e arsyeshme", ka thënë Bajrami.
Udhëheqësit e Sindikatës së të Punësuarve të Komunës së Mitrovicës, Vushtrrisë dhe Rahovecit, të cilit ishin të pranishëm në këtë konferencë, kanë thënë se kanë marrë mbështetjen edhe prej komunave të tjera, duke shtuar se në rast të mospërfilljes së kërkesave të tyre në fillim të javës së ardhshme do ta bëjnë publike datën e fillimit të grevës nga shërbyesit civilë në Komunën e Mitrovicës dhe më gjerë.

# MAShT-i dhe British Council arrijnë bashkëpunim rreth programit për shkollat e shekullit 21

PRISHTINË, 18 JANAR (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi dhe drejtori ekzekutiv i British Council për Kosovë dhe Shqipëri, Angus Bjarnason, kanë nënshkruar të premten memorandum mirëkuptimi për Programin për Shkollat e Shekullit 21, i cili synon përmirësimin e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët në Ballkanin Perëndimor. Ky program, i cili u zbatua me sukses si program pilot gjatë vitit 2017, ka për qëllim inkuadrimin e qasjes inovative për pajisjen e nxënësve nga mosha 10-15-vjeçare me shkathtësi për mendimin kritik dhe për zgjidhjen e problemeve përmes kodimit praktik dhe programimit fizik.
Nëpërmjet këtij programi udhëheqësit e shkollave do të kuptojnë dhe do të jenë në gjendje ta mbështesin inkuadrimin e metodave të reja dhe inovative të mësimdhënies si dhe do t'i motivojnë mësimdhënësit për t'i zbatuar ato në klasa. Ndërsa nga zbatimi i këtyre metodave nga ana e mësimdhënësve, nxënësit do të fitojnë shkathtësi të reja që, përveç të tjerash, do t'i rrisin aftësitë e tyre për të punuar në ekip, duke u siguruar atyre edhe mundësi më të mira të punësimit në të ardhmen.



# SBAShK-u, apel MAShT-it dhe DKA-ve: Lërini përpjekjet e kota për ta thyer grevën



EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 18 JANAR - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës e Kosovës (SBAShK) nëpërmjet një komunikate për media të premten i ka bërë apel Ministrisë së Arsimit, drejtorive komunale të arsimit dhe drejtorive komunale që t'i lënë përpjekjet e kota për të tentuar që të thyhet greva në arsim. "Grevistët janë këmbëngulës të qëndrojnë në grevë deri në realizimin e kërkesave të tyre në të gjitha rrethanat. Përndryshe, detyrohet SBAShK-u ta zbatojë pikën 3.1 të nenit 10 të Ligjit për greva, që mundëson që të punësuarit të mos paraqiten fare në vendin e punës", është thënë në reagimin e SBAShK-ut.
SBAShK-u i është drejtuar MAShT-it, drejtorive komunale të arsimit dhe drejtorëve të institucioneve arsimore që sa më shpejt t'i realizojnë kërkesat e tyre që mos të humben orë mësimore pasi në sektorët e tjerë ditët e grevës nuk zëvendësohen. "Duke u bazuar në të dhënat e mëparshme, u drejtohemi institucioneve të gjejnë kurajë për ngritjen e koeficienteve për 30 për qind nga punëtorët teknikondihmës e deri te rektori ose nga çerdhet deri tek universitetet apo varianti tjetër më i mirë i mundshëm, duke pasur parasysh se ky ligj ka shumë mangësi për të punësuarit në sektorët publikë me kualifikim të njëjtë dhe për punë të ngjashme të tërhiqet ky ligj në mënyrë që të ulen bashkërisht institucionet me punëtorë dhe të bëjnë një ligj të ri, ku të gjithë sektorët do të jenë të radhitur në vendin e tyre meritor", është theksuar në reagimin e SBAShK-ut.

# Diskutohet për sistemin e ri të përgjegjësive disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve

PRISHTINË, 18 JANAR (ER) - Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Bahri Hyseni, në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, ka mbajtur të premten një takim koordinues për të diskutuar për zbatimin e Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në këtë takim morën pjesë përfaqësuesit e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Zyrës së BE-së, kryesuesi i Komisionit për Çështje Normative të KGJK-së, drejtori i sekretariatit të KPK-së dhe drejtori i sekretariatit të KGJK-së.
Kryesuesi i KPK-së, Bahri Hyseni, ka thënë se qëllimi i këtij takimi të përbashkët me përfaqësuesit e KGJK-së dhe partnerët ndërkombëtarë është diskutimi i hapave konkretë që kërkohen me ligjin e ri për zbatimin e suksesshëm të sistemit të ri të përgjegjësive disiplinore. "Transformimi i sistemit disiplinor kërkon parapërgatitje intensive për vendosjen e çështjeve të rëndësishme në binarë të duhur dhe për të bërë ndryshimin brenda afateve të përcaktuara kohore", ka theksuar Hyseni.
Në këtë takim u arrit pajtimi që të dy këshillat ta udhëheqin procesin e transformimit të sistemit disiplinor përmes hartimit të akteve përkatëse normative, përfundimit të raporteve që janë në punë dhe përgatitjen për trajtimin e rasteve të reja, ashtu siç parashihet me ligjin e ri për përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Gjithashtu, në vijim u mor edhe mbështetja nga ana e partnerëve ndërkombëtarë për procesin e zbatimit të sistemit të ri të përgjegjësive disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.



# Haradinaj pret në takim 120 studentë nga Vjena dhe Venediku

Kryeministri Ramush Haradinaj ka pasur të premten një bashkëbisedim me 120 studentë nga Vjena dhe nga Venediku të cilët kishin ardhur për vizitë në Kosovë. Kryeministri Haradinaj u ka treguar studentëve rreth punës së vet si kryeministër, por edhe për jetën familjare, duke thënë se ka një vizion të mirë për Kosovën



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 JANAR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të premten në takim 120 studentë nga Vjena dhe Venediku, programi i studimeve "European Master in Human Rights and Democratisation", me të cilët ka zhvilluar bashkëbisedim, duke i njoftuar ata për bashkëjetesën ndëretnike, arsimin, proceset politike të vendit, demokratizimin dhe të drejtat e njeriut, dhe ku Kosova si vend me diversitet kulturor, etnik dhe fetar, është shtëpi e përbashkët e të gjithëve, ku respektohen të drejtat e secilit.
Haradinaj, duke u uruar mirëseardhje në Kosovë, para studentëve nga Vjena dhe Venediku ka theksuar se kanë rastin të mësojnë shumë për Kosovën.
Kryeministri Haradinaj u ka folur studentëve për punën e vet si kryeministër, por edhe për jetën e vet familjare, duke u thënë atyre se ka një vizion të mirë për Kosovën. "Sot rritja ekonomike për Kosovën është më e madhja në regjion. Luftën me korrupsionin nuk e kemi fituar ende, mirëpo kemi bërë progres", është shprehur kryeministri Haradinaj, duke shtuar se Qeveria që udhëheq ai është Qeveri që implementon dhe ka punuar me të gjitha partitë politike dhe me etnitete të ndryshme.
Kryeministri i ka informuar studentët se Kosova është shumetnike dhe qëllimi i saj është integrimi euroatlantik sepse i përket familjes evropiane dhe është në miqësi të përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. "NATO-ja, e udhëhequr nga Amerika dhe aleatët e tjerë, në vitin 1999 e ka ndihmuar Kosovën që të ndalet tragjedia mbi të", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke vlerësuar se intervenimi i NATO-s në Kosovë ka pasur karakter humanitar.
Haradinaj i është përgjigjur interesimit të studentëve për shumë çështje rreth Kosovës, si për: zhvillimin ekonomik, marrëdhëniet e Kosovës me shtetet e tjera, me theks të veçantë me Serbinë, për perspektivën e të rinjve, legjislacionin dhe shumë tema të tjera.

# MTI-ja kërkon respektimin e urdhëresës për vendosjen e çmimeve të derivateve

Zëvendësministrja e Tregtisë dhe Industrisë, Arbëreshë Krasniqi, ka vazhduar edhe të premten kontrollet në pikat e derivateve për ta mbikëqyrur zbatimin e urdhëresës që obligon vendosjen e çmimeve nëpër tabela në mënyrë që të shihen nga konsumatorët



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 18 JANAR - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka vazhduar edhe të premten kontrollet në pikat e derivateve për ta mbikëqyrur zbatimin e urdhëresës të ministrit të MTI-së, Endrit Shala, që obligon vendosjen e çmimeve nëpër tabela në mënyrë që të shihen nga konsumatorët.
Zëvendësministrja e MTI-së, Arbëreshë Krasniqi, ka theksuar se do të vazhdohet mbikëqyrja në tërë Kosovën dhe, sipas saj, kjo urdhëresë është edhe një hap më tutje në mbrojtjen e konsumatorit. "Ne sot kemi dalë të shohim se a kanë filluar ta respektojnë urdhëresën e ministrit Shala për vendosjen e çmimeve nëpër tabela në hyrje të pikave të shitjes së derivateve. Sigurisht se do të vazhdohet në krejt Kosovën për ta inspektuar se a po zbatohet urdhëresa, që është edhe një hap tutje për mbrojtjen e konsumatorit që ne si MTI e kemi për qëllim", ka theksuar Krasniqi.
Zëvendësministrja ka shtuar se arsyeja e kësaj urdhërese është që konsumatori të ketë transparencë të çmimeve dhe të vendosë ku ai dëshiron të furnizohet me derivate. "Arsyeja është që konsumatori ta shohë çmimin e derivateve dhe, krahas çmimit, ai bën përzgjedhjen se ku dëshiron të furnizohet. Kjo është në interes të qytetarëve dhe ne bëjmë thirrje që urdhëresa të respektohet nga operatorët ekonomikë përndryshe, nëse nuk respektohet, ka edhe pasoja", ka thënë Krasniqi.

Flet për "Epokën e re", Lulzim Rafuna

# Angazhimi i dy qeverive



**Lulzim Rafuna, këshilltar për tatime dhe doganë i kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se bashkëpunimi ekonomik Shqipëri - Kosovë asnjëherë nuk ka qenë më i mirë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Rafuna ka theksuar se të dyja qeveritë kanë bërë shumë për ta eliminuar burokracinë, megjithatë ai thotë se nuk duhet të jemi të kënaqur me kaq, pasi mund të bëhet më shumë. Ai ka thënë se hapja e Zyrës Doganore e Doganës së Kosovës në portin e Durrësit do t'i ndihmojë shumë tregtisë mes dy vendeve, por edhe më gjerë.**
**Rafuna ka thënë se marrja e vendimeve nga të dy shtetet dhe zbatimi i marrëveshjeve nuk ka qenë asnjëherë më i madh dhe më i shpejtë**

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

Prishtinë, 18 janar -
**"Epoka e re":** *Z. Rafuna, Dogana e Kosovës ka hapur këtë javë Zyrën Doganore në Portin e Durrësit. Çfarë do të thotë kjo për Kosovën?*
**Rafuna:** Ka qenë një vullnet dhe përkushtim shumë i madh i kryeministrit Rama për t'i ofruar Qeverisë së Kosovës në shfrytëzim portin e Durrësit për Doganën e Kosovës. Pas një pune shumë të madhe edhe nga Kosova, nga ana e ministrit të Financave, Bedri Hamza, më në fund kjo u bë realitet. Tani në mënyrë zyrtare është hapur edhe Zyra Doganore e Doganës së Kosovës në portin e Durrësit. Kjo do të thotë se është një vendim i veçantë dhe i madh në çdo pikëpamje, sidomos në aspektin e zhvillimit ekonomik. Kjo zyrë do t'i ndihmojë shumë tregtisë mes dy vendeve tona dhe më gjerë. Më pas do të ketë efekt pozitiv për lehtësimin e të bërit biznes për arsye se shpenzimet dhe koha do të jenë shumë më të vogla për biznesin sesa që ishin deri më tani. Por, më duhet të potencoj me këtë rast se është vetëm hapi i parë i cili është filluar me procedurën e transitit. Me avancimin e Doganës së Kosovës si në pikëpamje të IT-së dhe kapaciteteve njerëzore duhet avancuar edhe në procedura të tjera. Qeveria e Shqipërisë, nën udhëheqjen e kryeministrit Edi Rama, ka ofruar në shfrytëzim për Qeverinë e Kosovës, për Zyrën Doganore të Doganës Kosovës, të gjitha procedurat doganore. Është për t'u admiruar një vullnet i këtillë i kryeministrit Rama për ta avancuar bashkëpunimin me Kosovën, me mundësitë dhe obligimet që ka marrë përsipër, që ta thellojmë zhvillimin ekonomik.

**Epoka e re":** *Sa po e shfrytëzon Kosova këtë mundësi që ka ofruar kryeministri Rama?*
**Rafuna:** Kosova është duke e shfrytëzuar këtë mundësi dhe po shkon duke u avancuar bashkëpunimi, sidomos në dy vjetët e fundit. Nëse e shkoni mënyrën e marrjes së vendimeve, marrëveshjeve dhe zbatimin e tyre, ky bashkëpunim nuk ka qenë asnjëherë më i madh dhe më i shpejtë nga ana e institucioneve. Ne duhet të pajtohemi që jemi dy tregje të vogla, ndoshta jo në krahasim me Malin e Zi dhe Maqedoninë, por me fqinjin tjetër po, andaj duhet të avancojmë që në kuptim të zhvillimit ekonomik të funksionojmë si një treg i vetëm në mënyrë që të kemi një treg prej pesë milionë eurosh dhe të jemi tregu më konkurrent në këtë pjesë të Evropës në Ballkan. Në këtë mënyrë do të jemi edhe më atraktivë për investime të huaja. Përveç kësaj, ne kemi një mundësi unike që duhet shfrytëzuar për shkëmbimin e produkteve në mes të dy shteteve tona në periudha të ndryshme për arsye të klimës dhe, nëse nuk rrisim koston me procedura dhe dokumente të panevojshme, pa dyshim se do të avancohet bashkëpunimi. Në vazhdën e kësaj është bërë edhe avancimi i procedurave doganore në Morinë-Vermicë dhe hapja e Zyrës Doganore në portin e Durrësit. Për të gjitha këto duhet falënderuar edhe ministrin Bedri Hamza i cili në një afat shumë të shkurtër kohor ka filluar t'i implementojë të gjitha obligimet e marra vetëm që ta ndihmojë zhvillimin e biznesit.

**"Epoka e re":** *Cilat do të jenë kriteret bazë të këtij operimi?*
**Rafuna:** Nuk ka ndonjë kushtëzim nga ana e Qeverisë së Shqipërisë. Siç e thashë edhe më parë, porti i Durrësit është dhënë në shfrytëzim pa ndonjë kusht nga ana e Qeverisë së Shqipërisë. Dogana e Kosovës ka filluar procedurën e transitit, si procedura më e lehtë për të avancuar tutje dhe kjo kompleton figurën e lehtësisë së të bërit biznes kur kihet parasysh që në të njëjtën kohë kemi bërë edhe avancim në kufirin Vërmicë - Morinë, duke i vendosur në objekt të përbashkët zyrtarët doganorë të dy doganave, Shqipërisë dhe Kosovës. Kjo nënkupton se nuk do të ketë dy ndalje, nuk do të ketë dy

# eliminoi burokracinë



kontrolle dhe nuk do të ketë dy pagesa (shpenzime dhe dokumente për agjentët doganorë të të dyja vendeve), por të gjitha këto do të shkurtohen në një procedurë, një kontroll për dy administrata dhe një agjent doganor për vetëm një palë dokumente. Kjo përkthehet jo vetëm në kohë më të shkurtër që është prapë kosto më e shkurtër për biznesin, por edhe eliminim të burokracisë dhe dokumente më pak.

**"Epoka e re":** *Për çfarë kapacitetesh të operimit mund të flasim?*
**Rafuna:** Në portin e Durrësit, në të gjitha terminalet, duke përfshirë edhe Porto Romano, në muaj sillen nga 11 000 kontejnerë deri në 16 300, varësisht muajit të vitit. Sa iu përket kushteve të punës, përkatësisht të operimit, të dyja doganat kanë sistem të IT-së shumë të avancuar dhe i gjithë dokumentacioni është elektronik. Kjo mundëson nga çdo vend të dërgohen deklarata doganore dhe dokumentet e mallit në formë elektronike në Doganë. Pastaj, falë marrëveshjeve për bashkëpunim, por edhe reformave që janë bërë në dy administratat doganore, asaj të Shqipërisë dhe të Kosovës, ka avancim në mënyrën e punës sipas praktikave më të reja të BE-së. Kjo mundëson që të gjitha procedurat të zhvillohen pa ndonjë sfidë.

**"Epoka e re":** *A është bërë ndonjë plan projekt se si do të ndikojë kjo në lehtësirat biznesore mes dy shteteve?*
**Rafuna:** E thashë edhe më parë, përfitimet e biznesit do të jenë shumë më të mëdha sesa që ishin deri më sot. Kjo nënkupton që për mallin i cili ka destinacion Kosovën që nga momenti i paraqitjes në portin e Durrësit do ta fillojë procedurën pranë Doganës së Kosovës dhe me agjentë doganorë kosovarë që nuk ka qenë rasti deri më tani. Pra, është eliminuar komplet procedura fizike e Doganës së Shqipërisë. Kjo tani e lehtëson shumë mënyrën e të bërit biznes.

**"Epoka e re"***: Sa i përket kostos së skanimit dhe procedurave të tjera, do të jenë të njëjta apo...?*
**Rafuna:** Këto janë çështje që besoj se do të trajtohen në të ardhmen për ta parë edhe këtu sa ka mundësi të bëjmë ndonjë lehtësim.

**"Epoka e re":** *Pse u anashkalua porti i shumëfolur i Shëngjinit?*
Rafuna: Në këtë rast ne po flasim për lehtësimin e të bërit biznes. Të gjithë kontejnerët që kanë destinacion Kosovën vijnë përmes portit të Durrësit, për këtë arsye edhe Zyra Doganore e Doganës së Kosovës është hapur në portin e Durrësit.

**"Epoka e re":** *Kjo Zyrë Doganore e Doganës së Kosovës u cilësua si bashkim i tregjeve Kosovë - Shqipëri. A mund të pritet që partneri kryesor i shkëmbimeve tregtare për Kosovën të jetë Shqipëria?*
**Rafuna:** Jam shumë i lumtur që bashkëpunimi ekonomik Shqipëri - Kosovë dhe anasjelltas asnjëherë nuk ka qenë më i mirë dhe shifrat po tregojnë rritje çdo vit në të dyja anët. Se a është i mjaftueshëm, natyrisht se jo. Ka hapësirë shumë për të bashkëpunuar mes bizneseve në çfarëdo forme të organizimit. Më pas duhet punuar që të avancojmë në shkëmbimin më të madh edhe në strukturë më të llojllojshme të mallit. Duhet punuar në mënyrën dhe metodologjinë e avancimit të ofrimit të produktit tonë, por edhe të Shqipërisë te konsumatori, në mënyrë që të fillojë konsumatori të familjarizohet me produktet tona, që t'i zëvendësojmë ato me të huajat. E gjithë kjo punë kërkon përkushtim dhe avancim tutje jo vetëm të institucioneve shtetërore, por edhe të komunitetit të biznesit, medieve, bizneseve individuale, universiteteve etj. Të dyja qeveritë kanë bërë shumë për ta eliminuar burokracinë. Dhe, nëse e shikojmë me të kaluarën, ka shumë lehtësira, por prapë nuk duhet të jemi të kënaqur, për arsye se ende mund të bëjmë edhe më shumë, por që nevojitet, siç e thashë, edhe mbështetje dhe hapa konkretë edhe nga komuniteti i biznesit që të jetë më agresiv jo vetëm me kërkesa ndaj institucioneve, por edhe për ofrimin e produktit të konsumatorit për ta fituar besimin e konsumatorit dhe për t'i zëvendësuar produktet e huaja me ato vendore.

# BERZh-i konfirmon përkrahjen për sektorin privat dhe publik

Ministri Hamza ka theksuar se BERZh-i paraqet njërin ndër partnerët kryesor për Kosovën për realizimin e projekteve me rëndësi

**Prishtinë, 18 janar (ER)** - Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka pritur të premten në takim drejtoreshën për Ballkanin Perëndimor të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), Zsuzsanna Hargitai, me të cilën ka diskutuar në lidhje me bashkëpunimin në mes të Qeverisë së Kosovës dhe BERZh-it.
Gjatë takimit ministri Hamza ka theksuar se BERZh-i paraqet njërin ndër partnerët kryesor për Kosovën për realizimin e projekteve me rëndësi. Ai ka theksuar rëndësinë e mbështetjes së Bankës për sektorin privat dhe ka inkurajuar Bankën për mbështetje të vazhdueshme të këtij sektori. "Sektori privat është bartës kryesor i zhvillimit dhe rritjes ekonomike në vend, andaj mbështetja e Bankës është e domosdoshme për të arritur këtë qëllim. Sa i përket sektorit publik, ky vit pritet të jetë vit i realizimit të projekteve për të cilat konstruksioni financiar është i siguruar", ka shtuar ministri Hamza.
Ndërsa drejtoresha e BERZh-it, Zsuzsanna Hargitai, ka vlerësuar lart bashkëpunimin e Bankës me institucionet e Kosovës dhe ka shtuar se për projektet me rëndësi strategjike mbështetja e BERZh-it nuk do të mungojë. Ajo ka theksuar se BERZh-i do të vazhdojë të ofrojë mbështetje për sektorin privat dhe publik nëpërmjet formave të ndryshme të asistencës.



# Afati për të paraqitur kërkesë për prerjen e pyjeve në Skenderaj është deri më 29 mars

SKENDERAJ, 18 JANAR (ER) - Komuna e Skenderajt, përkatësisht Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, ka bërë me dije se afati për paraqitjen e kërkesave për prerje të pyjeve private ka filluar nga 3 janari dhe do të vazhdojë deri më 29 mars. "Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural njofton të gjithë qytetarët e Komunës së Skenderajt se nga data 3 janar deri më 29 mars është afati për të paraqitur kërkesë për prerjen e pyjeve në sektorin privat. Gjatë kësaj periudhe drejtoria në fjalë do ta bëjë pranimin e kërkesave për prerje të pyjeve. Dokumentet e nevojshme për aplikim: certifikata me të dhënat e pronësisë private dhe kopja e planit me koordinata", ka njoftuar Komuna e Skenderajt.





# QKMF-ja në Prizren ofron shërbime të avancuara laboratorike

PRIZREN, 18 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka bërë me dije se Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në këtë komunë do të ofrojë shërbime të avancuara laboratorike. Ai ka thënë se shërbime të tilla ofrohen për herë të parë nga një QKMF. "Për herë të parë në Kosovë një Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare do të ofrojë shërbime më të avancuara laboratorike. Nga e premtja në QKMF - Prizren do t'i fillojmë shërbimet laboratorike për analiza të hormoneve të gjëndrës tiroide dhe yndyrave. Me anë të këtyre analizave qytetarët me kohë do të mund t'i parandalojnë shumë sëmundje si dhe të kursejnë para. Kjo është një arritje e Drejtorisë së Shëndetësisë, e cila tashmë është vendosur në objektin e QKMF-së, për të qenë më pranë personelit dhe për të pasur koordinim më të mirë me ta", ka thënë Haskuka.

# Komuna e Mitrovicës, mirënjohëse ndaj UNHCR-it

MITROVICË, 18 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka pritur të premten në takim shefin e misionit të UNHCR-së për Kosovë, Erol Arduç, me të cilin ka biseduar për bashkëpunimin dhe kontributin e deritanishëm që UNHCR-ja ka dhënë për Komunën e Mitrovicës. Kryetari Bahtiri i ka shprehur mirëseardhje Arduçit, duke e uruar me rastin e marrjes së detyrës së re të shefit të misionit të UNHCR-së për Kosovë. Bahtiri ka thënë se Komuna e Mitrovicës është mirënjohëse ndaj UNHCR-it, të cilët në vazhdimësi kanë ofruar ndihmën dhe mbështetjen e nevojshme në drejtim të mbrojtjes, promovimit dhe përmirësimit të respektimit të të drejtave të njeriut në Kosovë. Në këtë takim u diskutua edhe për projektet e përbashkëta të Komunës së Mitrovicës dhe UNHCR-së në fushën e migrimit, duke vlerësuar se institucionet e Kosovës janë duke menaxhuar mirë çështjen e azilkërkuesve në Kosovë.

Ndërsa shefi i misionit të UNHCR-së për Kosovë, Erol Arduç, ka falënderuar kryetarin Bahtiri për realizimin e këtij takimi, i cili do të shërbejë si vazhdimësi e përpjekjeve tona, në kontekst të ndërmarrjes së veprimeve të përbashkëta për të mirën e qytetarëve të vendit dhe për mbrojtjen e të drejtave të tyre.



# Komuna e Skenderajt shpall konkurs për bursa studentore

SKENDERAJ, 18 JANAR (ER) - Komuna e Skenderajt ka shpallur konkurs publik për bursa studentore. Vlera e përgjithshme e kësaj mbështetjeje është 50 mijë euro, nga të cilat do të përfitojnë 100 studentë, përkatësisht 500 euro për student. "Ky është vetëm një nga veprimet tona drejt përmirësimit dhe sigurimit të kushteve më të mira për studentët e komunës sonë për avancimin e tyre profesional", ka thënë kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari. Për informata më të hollësishme rreth konkursit mund ta vizitoni faqen zyrtare të Komunës së Skenderajt.



# Komuna e Prishtinës përkujdeset për të moshuarit

PRISHTINË, 18 JANAR (ER) - Qendra Sociale për të Moshuar në Prishtinë është e mbushur me të moshuar të cilët e kalojnë ditën së bashku, shoqërohen dhe luajnë me njëri-tjetrin. Sipas një njoftimi të Komunës së Prishtinës, përveç hapësirave për lojë shahu, domino e të ngjashme, në këtë Qendër Sociale për të Moshuar janë edhe këndet e leximit, këndet e lojërave, këndet për punë dore, këndet e pushimit, si dhe hapësirat për përcjelljen e kanaleve televizive. "Kjo Qendër është e para e këtij lloji në Prishtinë, me mundësi që të bëhen të tilla të ngjashme edhe në lagje të tjera", është bërë me dije në njoftimin e Komunës së Prishtinës.



# Putini në Beograd, asgjë e re nga aleanca e vjetër



Prof. Lisen BASHKURTI

Mbas një procesi parapërgatitor të gjatë presidenti Putin erdhi në Serbi ose, thënë në termat gjeopolitikë, erdhi në 'Rusinë e vogël'. Nuk ka vend tjetër në këtë pjesë të botës më rusofil se Serbia. Gjithashtu, nuk ka fuqi tjetër botërore më proserbe se Rusia. Aleanca strategjike ruso-serbe vijon të jetë në linjat e aksit tradicional. Kohët e fundit kjo aleancë po forcohet. Ndërkohë, përreth këtij aksi vërtitet dilematike politika dhe diplomacia e Bashkimit Evropian. Po ashtu, përballë këtij aksi qëndron e paqartë ShBA-ja, që vijon të lëkundet midis linjave tradicionale të Luftës së Ftohtë dhe përpjekjeve për një rend të ri botëror.

## Gjeopolitika ruse - 'back to the future'

Federata Ruse në drejtimin e presidentit Putin po ndjek principin 'back to the future', pra 'mbrapa drejt së ardhmes'. Që në krye të herës shumë studiues dhe analistë, politikanë dhe diplomatë, e kanë definuar gjeopolitikën e Putinit si përpjekje serioze për t'i rikuperuar humbjet e Rusisë tradicionale të Pjetrit të Madh, sikundër edhe ato të shpërbërjes së BRSS-së. Thënë ndryshe, Putini po tenton t'i rimarrë terrenet e humbura në gjeopolitikën ruso-sovjetike dhe ta imponojë praninë dhe hegjemoninë e vet në sistemin e sotëm të marrëdhënieve ndërkombëtare. Kjo tentative restauratore e Putinit nuk mundësohet gjithaq nga zhvillimet e fuqizimet e brendshme të Rusisë sesa nga dobësitë dhe konfuzioni i rivalëve dhe kundërshtarëve të saj kryesorë në Perëndim. Tendenca restauratore gjeopolitike e Putinit, në pamundësi për të zhvilluar dhe fuqizuar ekonomikisht Rusinë së brendshmi, po shfrytëzon dy mënyra kryesore: së pari, dobësitë e kundërshtarëve më të mëdhenj gjeopolitikë botërorë, pra të BE-së dhe të ShBA-së si dhe ringjalljen e lidhjeve tradicionale bazuar në racën sllave, ortodoksinë dhe ideologjinë.

Lidhur me mënyrën e parë, vërehet qartësisht se Federata Ruse po rritë agresivitetin e vet me rrugë dhe metoda të sofistikuara për praninë dhe ndikimin e saj në jetën politike të ShBA-së. Debati në vazhdim për ndikimin rus në zgjedhjet e fundit presidenciale të ShBA-së, edhe nëse mund të jetë fiktiv ose i ekzagjeruar (kjo ngelet për t'u provuar), sërish ka zënë vend të konsiderueshëm në perceptimin e gjerë të opinionit publik amerikan dhe botëror. Në hapësirën gjeopolitike të BE-së perceptimi në rritje është se Federata Ruse po qëndron më së shumti prapa çdo krizë të brendshme të organizatës. Brexit, rritja e euroskepticizmit, gjallërimi i lëvizjeve populiste dhe nacionaliste, konsiderohen si të mbështetura nga Rusia.

Lidhur me Ballkanin Perëndimor vizita e Putinit në Beograd qartësoi publikisht pozicionet e Rusisë. Rusia po ndërhyn haptazi në Ballkanin Perëndimor për frenimin e zgjerimit të BE-së dhe NATO-s. Pikëpamja ruse është së politika e Perëndimit, BE, NATO dhe ShBA, me strategjinë e zgjerimit, po e destabilizojnë Ballkanin Perëndimor. Rusia e akuzon Perëndimin se tërhoqi forcërisht Malin e Zi në NATO, se bëri ndërhyrje të sforcuar për Marrëveshjen e Prespës për të integruar Maqedoninë në NATO dhe BE si dhe kritikoi Greqinë për shërbimin ndaj interesave perëndimore në Ballkanin Perëndimor. Me pak fjalë, Rusia u deklarua botërisht se është kundër politikave perëndimore në Ballkanin Perëndimor, se do të bëjë gjithçka për ta penguar integrimin e këtij rajoni në BE dhe NATO. Serbia është 'leva e Arkimedit' për realizimin e synimeve ruse në këtë rajon.

Tendenca restauratore gjeopolitike e Putinit ka një mbështetje të dukshme dhe në rritje të opinionit të gjerë publik në Federatën Ruse. Sondazhet e kryera në fund të vitit 2018 nga 'Qendra Levada' në Rusi tregojnë se rënia e Bashkimit Sovjetik konsiderohet një arsye për t'u turpëruar nga 45 për qind e rusëve. Nga 28 për qind që ishte në mesin e vitit 2015 turpërimi për rënien e BRSS është rritur thuajse dyfish, ose baras-krahasuar me nivelet e viteve 1990 dhe fillimin e viteve 2000.

Reagimi i vetëm pozitiv më popullor në Rusi është turpërimi për dështimin e Rusisë për ta zhdukur varfërinë, që ka një dominim opinional me 61 për qind dhe që shpreh pakënaqësi edhe ndaj politikave ekonomike të presidentit Putin. Ndërkohë, sipas sondazheve, rusët ndihen krenarë në masën 45 për qind për përfshirjen e Krimesë si pjesë të Federatës Ruse. Ky tregues është shumë sinjifikativ për gjeopolitikën restauratore të Putinit. Pra, parimi 'back to the future' duket se gëzon një mbështetje opinionale në rritje në mjediset ruse. Ky tregues inkurajon ofensivën gjeopolitike të presidentit Putin.

## Serbia, 'Kali i Trojës' së Rusisë në Ballkan

Një nga mënyrat më efikase për zbatimin e parimit 'mbrapa drejt të ardhmes' është ringjallja e lidhjeve tradicionale të bazuar në racën sllave, ortodoksinë dhe ideologjinë pan ruse. Vizita e fundit e presidentit Putin në Serbi është prova më e dukshme për këtë. Putini erdhi në Serbi njëlloj si në 'Rusinë e vogël ballkanike". Nga ana tjetër, serbët e konsideruan Putinin si lideri botëror politik e shpirtëror i tyre, si shpresa për mbështetjen e interesave kombëtare dhe pozitave ndërkombëtare të Serbisë.

Serbia pret shumë nga Rusia ekonomikisht dhe strategjikisht. Ndërkohë që Rusia pret nga Serbia vetëm që të mos aplikojë sanksionet e BE-së kundër Rusisë dhe ta vijojë neutralitetin ndaj NATO-s strategjikisht. Putini përpiqet që ta lidhë Rusinë më shumë me shtetin e vetëm rusofil në Evropë. Ekonomikisht Putini nuk ka çfarë t'i ofrojë Serbisë. Paradoksalisht edhe gazi rus është në Serbi më i shtrenjtë se në Gjermani. Dhe premtimet për kalimin e gazsjellësve rusë nëpër territorin e Serbisë janë akoma ëndrra në sirtarë. Putini po përpiqet që me investime të pakta ekonomike të arrijë objektiva të mëdha politike brenda Rusisë dhe gjeopolitike jashtë Rusisë.

Në rrafshin strategjik Serbia pret shumë nga Rusia. Aleanca tradicionale ruso-serbe ka qenë historikisht aleancë ushtarake. Ndërkohë që Rusia është e kënaqur vetëm me neutralitetin strategjik të Serbisë. Ky neutralitet strategjik konsiderohet sukses i madh rus kundër zgjerimit të NATO-s në Ballkanin Perëndimor. Dhuratat e premtuara strategjike ruse për Serbinë, si avionët ushtarakë MiG-29, tanket e pajisje të tjera ushtarake, janë paguar paraprakisht nga Serbia. Ndërkohë 'Baza Humanitare e Nishit', me synimin për 'status diplomatik', synon t'i bëjë karshillëk 'Bazës Ushtarake të Bon Steel' në Kosovë. Për bashkëpunimin e gjerë bilateral ruso-serb, në Beograd u nënshkruan 21 marrëveshje bashkëpunimi. Letra shumë, para pak. Marrëveshjet lidhen me bashkëpunimin mes universiteteve, me energjinë atomike, me hekurudhat etj. Mirëpo ekonomia ruse e tkurrur nga kriza dhe nga sanksionet nuk afron gjë për të qenë për Serbinë. Rusët vetë më së shumti janë kritikë për gjendjen ekonomike të tyre. Prandaj Putini në rrafshin ekonomik synon kryesisht ta kufizojë efektin e sanksioneve ekonomike të BE-së për shkak të Krimesë, duke bërë diversion me shtete të veçanta, midis të cilëve me Serbinë. Putini e propagandon Serbinë në vendin e vet si arritje të madhe të politikës së tij me një shtet pranë anëtarësimit në BE.

Serbia vijon të bëjë një zgjedhje të sforcuar dhe artificiale midis Rusisë dhe Bashkimit Evropian. Është kjo një zgjidhje pa të ardhme. Herët ose vonë Serbia do të duhet ta përputhë politikën e saj të jashtme me atë të BE-së. Serbia është në procesin e negocimit për anëtarësim me BE.

Kapitulli 31 i negociatave për anëtarësim në BE parashikon një politikë të përbashkët të jashtme. Pra, ky kapitull e detyron Serbinë që t'i pranojë sanksionet kundër Rusisë. Përndryshe, Serbia nuk anëtarësohet në BE. Pa anëtarësim në BE, rruga e prosperitetit ekonomik të Serbisë ngushtohet. Prandaj çdo hap i Serbisë drejt afrimit me BE-në është në thelb një hap drejt largimit nga Rusia. Serbia nuk mund të rrijë gjatë në dilemën BE - Rusi. Serbia e di mirë se mund të anëtarësohet në BE vetëm nëse do t'i respektojë sanksionet e futura nga BE-ja kundër Rusisë për shkak të aneksimit të Krimesë.

Të vetëdijshëm se politika Serbe do të rrëshqasë drejt BE-së, Rusia dhe Serbia firmosën një marrëveshje të veçantë midis dy ministrave të jashtëm që parashikon planin për konsultime dypalëshe për periudhën 2019-2020. Kjo marrëveshje imponon që Serbia, së paku për dy vjet, të mos aplikojë sanksione ndaj Rusisë. Këtë fakt e vëren edhe vetë Vuçiqi, i cili shprehet për paqartësitë e BE-së lidhur me kapitullin 31. Në këtë periudhë paqartësie dilematike, mesa duket, Vuçiqi ka vendosur ta ndjekë politikën me dy vektorë BE - Rusi. Për këtë shërbim rusofil Vuçiqi u nderua me dekoratën e lartë ruse, njëlloj si Pashiçi. Vuçiqi dhe Pashiçi qëndrojnë në një nivel vlerësimi nga Rusia. Kohë të ndryshme, vlerësime të njëjta, liderë të përafërt.

## Projekti rus - Kosova si 'krizë e ngrirë'

Në aspektin e interesave kombëtare serbët presin shumë nga presidenti Putin. Në mënyrë të veçantë serbët shpresojnë shumë që Kosova të mbetet në Serbi. Gjatë vizitës së fundit të presidentit Putin në Beograd, çështja e Kosovës zuri vend të dukshëm në agjendën e bisedimeve dhe të deklarimeve publike. Presidenti Putin u shpreh qartazi kundër pavarësisë së Kosovës, duke e quajtur atë si një veprim i njëanshëm dhe kundër të drejtës ndërkombëtare. Me këtë deklaratë Putini injoroi opinionin këshillimor të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të 11 korrikut të vitit 2010, i cili e konsideroi shpalljen e pavarësisë së Kosovës jo në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare.

Presidenti rus u deklarua pro qëndrimeve serbe ndaj Kosovës. Ai tha prerazi se Rusia do të vijojë ta mbështesë këtë qëndrim serb dhe se nuk mund të ketë zgjidhje të çështjes së Kosovës pa pjesëmarrjen e Rusisë. Gjithashtu, Putini thekoi se Rusia do ta mbështesë çdo qëndrim serb në marrëveshjen me Kosovën në kuadër të Rezolutës 1244 të KS të OKB-së.

Zgjidhja që ofroi për Kosovën presidenti Putin është moszgjidhja. Opsioni rus është bllokimi i çështjes së Kosovës në një status-quo pa kurrfarë afati kohor. Kosova për Rusinë është një çështje e mbetur pezull. Ose, më saktë, thënë në termat gjeopolitikë ruse, "Kosova të mbetet krizë e ngrirë" sikundër janë përreth Rusisë, Osetia Jugore, Apkazia, Nagorni-Karabaku.

Presidenti rus Vladimir Putin nuk shpalosi asnjë lloj opsioni të ri në adresimin e çështjes së Kosovës. Putini vetëm ushqeu me lugë të zbrazur Serbinë, duke njohur sensibilitetin politik dhe opinional të serbëve. Ndërkohë mediat kanë theksuar se një opsion i mundshëm i mbështetur në prapaskenë nga Rusia është ai i shkëmbimit të territoreve midis Kosovës dhe Serbisë, që mediatikisht është mbështetur nga presidentët e dy vendeve, Kosovës dhe Serbisë.

Gjithsesi, mesa duket, diplomacia ruse do të vijojë ta mbajë çështjen e Kosovës në agjendën e saj diplomatike për tri arsye kryesore: si kazus për ta mbajtur të përçarë dhe të tensionuar Ballkanin Perëndimor; si mjet presioni dhe diversioni përkundër BE-së dhe politikave të saj të zgjerimit në Ballkanin Perëndimor; dhe si titfor-tat, pra si mjet shkëmbimesh dhe interesash në marrëdhëniet gjeopolitike me ShBA-në.

## Serbia, model rus apo perëndimor

Fjalët më të munguara në mendimet, qëndrimet dhe materialet e firmosura gjatë vizitës së presidentit rus, Vladimir Putin, në Beograd, ishin 'demokracia', 'të drejtat e njeriut', 'integrimi'. E gjithë vizita nuk mbante erë demokracie, pluralizmi, të drejta njeriu, ekonomi e tregut të lirë, mirëqeverisje. Gjithçka mbante erë modeli rus, që nga protokolli dhe ceremoniali e deri te përmbajtja dhe aktet formale.

Ky shqetësim u vu në dukje nga shumë organizata për të drejtat e njeriut në Serbi. Organizatat joqeveritare në Serbi tërhoqën vëmendjen se Serbia po ndjek modelin rus, të një lidershipi autoritarist larg nga modeli demokratik perëndimor. Ato theksuan se modeli autoritarist i Putinit nuk mund të jetë një model lidershipi për udhëheqjen serbe.

Organizatat joqeveritare në Serbi shfaqën frikën e tyre se vizita e presidentit Putin në Serbi mund të çojë në braktisjen e reformave dhe integrimit evropian të vendit. Sipas mediave, shumë OJQ prestigjioze serbe kanë frikë se vizita e presidentit rus po tregon se Serbia është e gatshme ta sakrifikojë respektimin e të drejtave të njeriut dhe një standard më të mirë prosperiteti të shoqërisë serbe për hir të marrëdhënieve të mira me Moskën. Shumë OJQ në Serbi, gjithashtu janë të mendimit se vizita e Putinit do ta rrisë autoritarizmin e presidentit Vuçiq në Serbi si dhe do t'i dobësojë institucionet demokratike, të drejtat dhe liritë e qytetarëve, nën arsyetimin e miqësisë tradicionale serbo-ruse.

Më 17 janar 2019 presidenti Putin erdhi në Serbi. Ishte një rikthim në 'Rusinë e vogël'. Rusofilia serbe dhe serbofilia ruse dominuan gjithë vizitën. U duk qartë se nuk ka vend tjetër në këtë pjesë të botës më rusofil se Serbia. Nuk ka fuqi tjetër botërore më serbofile se Rusia. Aleanca strategjike rusoserbe vijon të jetë në linjat e aksit tradicional. Kohët e fundit ky aks po forcohet. Ndërkohë, përreth këtij aksi vërtitet plot dilema Bashkimi Evropian. Sikundër qëndron e paqartë ShBA-ja, që po lëkundet midis linjave tradicionale të Luftës së Ftohtë dhe përpjekjeve për një rend të ri botëror. Vizita e djeshme e presidentit rus, Putin, në Serbi, nuk shënoi asgjë të re nga aleanca e vjetër.

## Një zyrtar i lartë koreanoverior viziton Uashingtonin



UASHINGTON, 18 JANAR - Një zyrtar i lartë i Koresë së Veriut ndodhet në Uashington për bisedime me homologun e tij amerikan përpara një takimi të pritshëm lidhur me çarmatimin bërthamor mes presidentit Donald Trump dhe udhëheqësit të Phenianit Kim Jong Un.
Kim Yong Chol, krahu i djathtë i udhëheqësit të Phenianit, mbërriti në Uashington të enjten në mbrëmje. Ai pritet të takohet me sekretarin e Shtetit Mike Pompeo përpara se t'i dorëzojë një tjetër letër për presidentin Trump.
Në takimin e tyre të parë në Singapor në muajin qershor, të dy udhëheqësit nënshkruan një dokument të formuluar në mënyrë të paqartë, sipas të cilit, udhëheqësi i Phenianit zotohej të punonte për çarmatimin bërthamor të gadishullit Korean.
Por Pheniani vazhdon të kërkojë lehtësimin e sanksioneve dhe ka hedhur poshtë kërkesat për atë që e quan çarmatim "të njëanshëm". Uashingtoni nga ana tjetër këmbëngul që masat ndëshkuese të mbeten në fuqi derisa Koreja e Veriut të heqë dorë nga arsenali i saj bërthamor.

# Trumpi ka udhëzuar avokatin e vet ta gënjejë Kongresin

Burime të medies në ShBA thonë se ish-avokati i presidentit amerikan, Michael Cohen, i ka thënë prokurorit të posaçëm Robert Mueller, se presidenti e pati udhëzuar atë ta gënjente Kongresin rreth marrëdhënieve të Trumpit me Rusinë




UASHINGTON, 18 JANAR - Sipas një njoftimi të medias, presidenti amerikan Donald Trump ka udhëzuar avokatin e vet ta gënjejë Kongresin lidhur me përpjekjet për të ndërtuar një kullë Trump në Moskë. Të enjten "BuzzFeed News" njoftoi se dy zyrtarë federalë të zbatimit të ligjit, emrat e të cilëve nuk bëhen me dije, janë burimi i informacionit lidhur me presidentin dhe ish-avokatin e tij Michael Cohen. Burimet thonë se Cohen i ka thënë prokurorit të posaçëm Robert Mueller se presidenti e pati udhëzuar atë ta gënjente Kongresin rreth marrëdhënieve të Trumpit me Rusinë. "BuzzFeed" njofton se dy zyrtarët federalë janë "të përfshirë në hetimin lidhur me këtë çështje". Po sipas shkrimit, Trumpi dhe dy fëmijët e vet, Ivanka dhe Donald Jr., "kanë marrë rregullisht informacione të hollësishme rreth çështjeve të lidhura me pasuritë e paluajtshme prej Cohenit, i cili ishte ngarkuar me këtë projekt".
Në të njëjtën kohë që Cohen i ofronte Trumpit informacione rreth negociatave me Rusinë, Trumpi ishte angazhuar në zgjedhjet presidenciale. Ai ka mohuar të ketë pasur ndonjë marrëveshje biznesi me Rusinë. "Pretendimi se presidenti i Shteteve të Bashkuara mund të ketë kryer një akt të paligjshëm përpara komisionit tonë në një përpjekje për ta kufizuar hetimin dhe mbuluar marrëveshjet e tij të biznesit me Rusinë është ndër më seriozët deri më tani", shkruante në një postim në "Twitter" ligjvënësi Adam Schiff. "Ne do të bëjmë gjithçka është e nevojshme për të gjetur nëse kjo është e vërtetë", tha ai.
Ligjvënësi Joaquin Castro në një postim në "Twitter" shkruante se nëse shkrimi i publikuar nga "BuzzFeed" është i vërtetë, Trumpi "duhet të japë dorëheqje ose të nisin procedurat për shkarkimin e tij".
Në artikullin e tij, "BuzzFeed" shkruan se ka mësuar rreth përpjekjeve të Trumpit që Cohen ta gënjente Kongresin përmes intervistave me dëshmitarë të shumtë nga organizata Trump, email-e të brendshme të kompanisë, mesazheve telefonike si dhe dokumenteve të tjera.
Ndërkohë të mërkurën Rudy Giuliani, një nga avokatët e Trumpit, pranoi se disa zyrtarë të fushatës së Trumpit mund të kenë bashkëpunuar me Rusinë për ta ndihmuar atë të fitojë, por tha se vetë Trumpi nuk është i përfshirë në këto përpjekje.
Të enjten Giuliani u përpoq të sqarojë deklaratën e tij duke thënë se: "unë përfaqësoj vetëm presidentin Trump dhe jo njerëzit e fushatës së tij. Nuk ka asnjë lloj marrëveshjeje të fshehtë nga ana e presidentit Trump të asnjë mënyre a forme. Gjithashtu nuk jam në dijeni nëse mijëra njerëz të fushatës së tij kanë bashkëpunuar në mënyrë të fshehtë", tha ai.



# Gjermania i kërkon Rusisë ta parandalojë garën në armatim

MOSKË, 18 JANAR - Ministri i Jashtëm i Gjermanisë, Heiko Maas, i bëri thirrje Rusisë që të ndihmojë në parandalimin e garës në armatim, duke e ruajtur një marrëveshje të rëndësishme për këtë çështje me Shtetet e Bashkuara.
Duke folur gjatë një vizite në Moskë, Maas kërkoi nga Rusia që të shkatërrojë një lloj rakete për të cilën Uashingtoni thotë se e shkel marrëveshjen.
Vitin e kaluar, presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ka thënë se SHBA-ja do të tërhiqet nga Traktati i Forcave Bërthamore me Rreze të Mesme, për shkak të shkeljeve të Rusisë. Duke reaguar ndaj deklaratave të Maasit, ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov, tha se Moska nuk e ka shkelur traktatin e vitit 1987.
Lavrovi tha se zyrtarët amerikanë e kanë njoftuar Rusinë se vendimi i tyre është përfundimtar dhe se nuk është i hapur për negociata.
Uashingtoni ka thënë se do të dalë nga marrëveshja në fillim të shkurtit nëse Moska nuk i ndalon shkeljet. Rusia e mohon se raketa në fjalë, 9M729, e shkel Traktatin e Forcave Bërthamore me Rreze të Mesme.

## May informon BE-në për etapat e ardhshme të Brexit



Londër, 18 janar- Kryeministrja britanike, Theresa May zhvilloi të premten biseda telefonike me liderët e Bashkimit Evropian për t'i vënë në dijeni për negociatat me opozitën, për arritjen e një kompromisi politik për kushtet e Brexitit.
Donald Tusk pas telefonatës me May-in postoi një mesazh në Twitter ku citonte bisedën dhe diskutimet me kryeministren për hapat e ardhshëm të palës britanike. "Ishte një shkëmbim informacionesh nga të dyja palët, të dy ramë dakord të jemi të kontakt të vazhdueshëm", tha një zëdhënëse e presidentit të Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker.
I pyetur nga media në lidhje me hipotezën e një shtyrje të datës së Brexitit të planifikuar për më 29 mars, Komisioni Evropian siguroi sërish se nuk i ishte parashtruar një kërkesë e tillë nga ana e Britanisë së Madhe.







# BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.






E rrallë

# Hoteli në Tokio heq nga puna 200 robotë




Të ngadaltë dhe të paaftë për t'iu përgjigjur kërkesave të klientelës, të paktën gjysma e punonjësve të hotelit 'Henn-na' në Tokio do të pushohen nga puna. Të gjithë këta punonjës janë robotë. Hoteli ishte bërë i famshëm sepse ishte ndër të parët në botë që kishte 200 robotë punonjës në vend të qenieve njerëzore.

FOTO E DITES



Një person noton në liqenin e ngrirë në Shenyang. /AFP/

E jashtëzakonshme

# Lagjja me vila përrallash ku nuk jeton njeri



Një lagje që ishte planifikuar si zonë luksi për blerës të huaj nuk e ka arritur qëllimin për të pasur sukses, duke u kthyer në një qytet fantazmë me vila përrallash. Nga larg, Burxh Al Babas, në Turqi, projekti nisi në vitin 2015 dhe ndërtuesi shpresonte që estetika e arkitekturës do të tërhiqte pasanikë të huaj. Por edhe pse vazhdon të ketë një buxhet prej 200 milionë dollarësh, grupi ndërtues, Sarot, ka shpallur falimentimin për shkak se nuk ka mundur t'i shesë pronat.

## BARSOLETA E DITËS



**Një gjakovar, i cili i kishte blerë dy tiketa të lotarisë, pasi e fitoi 'jackpotin', në vend se të gëzohej, nisi të bërtiste:**
**- Çka m'u desh t'i blej dy tiketa!**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC




Në ora 16:00
### "THE GRINCH" 3D,
I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney




Në ora 17:30
### "THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D
Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston




Në ora 19:30
### "MORTAL ENGINES" 3D,
Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers




Në ora 22:00
### "HUNTER KILLER",
Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Edhe pse po tentoni t'i qartësoni idetë tuaja, sot do të gjendeni të përfshirë nga aventurat dhe pasioni pa ndarë se nga cila anë do të qëndroni.



**DEMI**
Do të zhgënjeheni nga rezultati final i një projekti tek i cili kishit besuar shumë. Debate brenda mureve të shtëpisë për çështje financiare.



**BINJAKËT**
Komunikimi dhe kontaktet me miq të afërt e të largët sot do të jenë pjesë e ditës suaj. Një ftesë për të kaluar ditën larg familjes.



**GAFORRJA**
Rrjedha e ditës do t'ju përfshijë dhe do të harroni një takim që e kishit planifikuar prej kohësh. Mund t'ju prish punë në të ardhmen.



**LUANI**
Në një debat idesh ndërmjet jush dhe partnerit falë argumenteve do të dalë që partneri ka të drejtë. Mundohuni ta pranoni këtë gjë.



**VIRGJËRESHA**
Kreative dhe mjaft i disponueshëm me të tjerët, sot do ta tërhiqni vëmendjen e dikujt që do të jetë një histori e rëndësishme në të ardhmen.



PESHORJA
Dita do të shoqërohet me humor dhe argëtim në familje dhe me miqtë. Një surprizë gjatë mbrëmjes do t'ju gjejë totalisht të papërgatitur.



**AKREPI**
Ditë jo shumë e qetë kjo e sotmja dhe mjaft situata që nuk ju pëlqejnë. Do të dini si t'i zgjidhni, por gjithsesi do t'ju lënë shije të keqe.



SHIGJETARI
Një mesazh interesant sot do t'ju lumturojë. Më në fund personi që ju pëlqeni po i përgjigjet ndjenjës suaj.



**BRICJAPI**
Jeni fokusuar te shpenzimet sot dhe doni të tregoheni sa më kursimtar. Nëse planifikoni blerjet tuaja, do t'ia dilni të kurseni.



**UJORI**
Nuk keni shumë miq me planetët këtë periudhë. Ju kanë zgjuar pasigurinë dhe shikoni kundërshtarë edhe aty ku ata nuk ekzistojnë.



**PESHQIT**
Sot nuk po ju pëlqen fare dita si nga ana personale dhe profesionale. E vetmja gjë që ju tërheq janë natyra dhe miqtë e mirë.

# Joe Alwyn e cilëson lidhjen me Taylor Swiftin si 'normale'



Joe Alwyn dhe Taylor Swifti kanë qenë shumë të suksesshëm për ta mbajtur romancën e tyre dyvjeçare larg vëmendjes së publikut dhe mediave. Aktori ka deklaruar se në lidhjen e tyre të dashurisë nuk ka asgjë të çuditshme pavarësisht se çfarë ka dëgjuar ai së fundmi. Madje ai e ka cilësuar si lidhje dashurie krejt "normale". "Unë nuk mendoj se dikush që e takon në rrugë mund të t'i tregojë të gjitha gjërat personale, pse duhet ta bëj unë këtë? Kjo më pas definohet si diçka 'çuditërisht private'. Mendoj se lidhja jonë është normale", ka thënë ai në një intervistë për "MR Porter".



# Chopra dhe Jonas janë kthyer në shtëpi

Aktorja indiane Priyanka Chopra dhe bashkëshorti i saj, Nick Jonas, janë kthyer nga muaji i mjaltit në Karaibe. Ata kanë mbërritur në hotelin "Peninsula" në Beverly Hills të enjten ka raportuar "Daily Mail". Në fotografi shihen se kanë kaluar shumë mirë me njëri-tjetrin dhe janë të lumtur.

# Naomi Campbell ndryshon stilin e flokëve



© David Fisher/REX

Modeluesja e njohur Naomi Campbell ka ndryshuar stilin flokëve. Ky stil i modelueses tërhoqi vëmendjen e të gjithëve në pasarelën e modës së Louis Vitton në kuadër të Javës së Modës në Paris.



# Justin Bieberi dhe Hailey Baldwini caktojnë ditën e dasmës

Justin Bieberi dhe Hailey Baldwini thuhet se po planifikojnë ceremoninë e martesës në fund të muajit shkurt. Çifti i lumtur ka planifikuar të bëjë një festë të madhe për miqtë dhe anëtarët e familjes dhe se festat u janë dërguar mysafirëve për datën 28 shkurt. Vendi për ceremoninë ende nuk është zbuluar dhe se DJ personal i Bieberit do të jetë Tay James.

# Dallgët e dhimbshme të një deti varresh

Përsiatje rreth poemës "Deti i varreve" të autorit Ajet Shala. Asnjë metaforë tjetër nuk do t'i shkonte më shumë për shtat kësaj vepre të re poetike të Ajet Shalës.

Nga Namik SELMANI, shkrimtar

Kush ka përvojën e vënies së titujve në veprat e tij kujton se nganjëherë ato vihen në fillim. Nganjëherë vihen në fund. Shumë herë për ta matur mençurinë tonë e për ta arritur atë në maja të reja marrim edhe mendimet e miqve tanë kudo ku janë.

Pa pasur një vulë poetike do të thosha se "Deti i varreve" i vë edhe më mirë kurorën librit më të ri të tij. Poetët janë të mësuar ose më saktë, janë të përkëdhelur kur kujtojnë detin. E më tej, për t'u bërë paksa romantikë aq dhe epikë në atë që duan të thonë me vargjet e tyre, pavarësisht se sa jetëgjatë do të jetë poezia e tyre, ata bëjnë sa e sa metafora me të. I shtojnë atij fjalët dashuri, dhimbje, urrejtje, krisma, shkronja, lumturi, këngë, valle etj. E të gjithë metaforat me të kanë nisur që në foshnjërinë e poezisë së botës.

Në secilën gjuhë të botës fryma e poetëve është e njëjtë me rebelimin me romantizmin e tyre, se kudo metafora "Deti i varreve" është e njëllojtë edhe në ato vende ku mungojnë detet, pse jo dhe lumenjtë që e ushqejnë detin me ujë me valë.

Kudo ku poetët gdhihen e ngrysen pas një dritareje, pas një perdeje fluturore, para një vargu, sërish në tavolinat e tyre vjen deti, vjen vala e dallga e tij. Vjen misteri i tij. Edhe pse dritarja e pragu i poetëve nuk sheh agime të flakëruar e muzgje të trëndafiltë, apo atë formulë magjike të dashurisë "Të dua!" sërish ata e duan detin në vargje. E ky kod metaforik "Deti i varreve" duket se na jep edhe çdo lexuesi një dallgëzim të fortë vargjesh dhe mbresash.

Simbolika e detit do t'i shkonte shumë edhe historisë shqiptare, aq më shumë asaj të gjysmës së shekullit XX. Në Kosovë e në Tivar bëhej një masakër e madhe, ashtu si bëhej edhe në trojet e lashta çame, masakra çame e shpërngulјes dhe e vrasjes së mijëra njerëzve të pafajshëm. Është një përqafim i hidhur ngjarjesh, vitesh, masakrash.

Masakra e Tivarit që Ajet Shala e bën objekt të poemës së tij poetike, në vitin 1945, do të shoqërohen nga masakra çame e viteve 1944-1945. Madje duhet të themi se këtë masakër poeti Kopiliqas e ka pasur prej kohësh në planet e tij krijuese. Filizët e poemës kanë lindur në secilin libër me poezi ku ai ka vënë motive të shkëputura nga kjo masakër.

Për këtë ai kërkon që të shkruajë e të botojë edhe një poemë për këtë masakër. Urojmë që ta ketë sa më të lehtë misionin e tij poetik.

Le të kthehemi në portat e poemës së re.

Ajet Shala është pjesa më e dhimbshme e kësaj masakre. Jo vetëm si poet që do ta përcjellë te lexuesi. Një jetë të tërë ai ka dëgjuar për të. Natyrisht së pari dëgjoi nga gjyshi i tij, nga babai i tij. Më vonë u mor me librat, me arkivat.

Dhe shumë libra lexoi për të. Ndiente një lloj pengu së gjalli për të ndarë e bërë dhe tash po ua paraqet lexuesve të të gjithë trojeve që nga Kosova e deri në diasporë. Po ta shohësh nga gjinia e saj, ajo është një poemë historike me ngjarje e personazhe konkretë.

Është një lloj "Këngët e Milosaos" të ditëve tona. Është një lloj "Kënga e Spapsme e Balës" e Gavril Darës.

Palët kundërshtare në këtë vepër janë mjaft të spikatura e nuk të lënë asnjë pikë dyshimi. Është një dritëhije ku të gjithë e shohin veten. Është një marshim që të ngërthen poetikisht me atë hap të dhimbshëm që e shoqëron secilin pjesëmarrës të tij.

Janë botuar disa vepra për këtë masakër. Madje një poemë të tillë me këtë tematikë e ka botuar edhe miku im Gjokë Dabaj që, gjithashtu, u është referuar personazheve të ngjarjeve. Për hir të së vërtetës ende ka mistere për këtë ngjarje të rëndësishme me shqiptarët në marrëdhëniet e tyre me fqinjët dhe me vetë komunistët shqiptarë të kohës. Njeriu vdes kur harrohet, ka thënë Sokrati. Mbase këtij mendimi të artë do t'i shkonte më saktë edhe kjo ngjarje e pabesë e tradhtisë.

Poeti nuk është arkivist i mirëfilltë në poemë. Aty ka mjaft shpërthime poetike të dhimbjes së dashurisë të personazheve. Në qendër ai ka vënë kryesisht shqiptarët që vijnë në formë e një ëndrre të egër të gjyshit të tij Bajram.

Po, Bajrami është një personazh real, një personazh historik i vërtetë që e rrëfen ngjarjen dhe poeti i ka dhënë këtij rrëfimi ngjyrimin poetik. Ai nuk stis. Ai nuk sajon. Ai është pjesa më e dhimbshme e marshimit dhe e masakrës së Tivarit.

Rrëfimi i tij poetik është dhimbje, është dashuri, është zhgënjim, por edhe krenari për atë forcë të madhe shpirtërore që patën shqiptarët në këtë masakër historike.

Në këtë poemë ai nxjerr qartë në dritën e diellit edhe qëllimet e egra të pushtuesit sllavë që falë edhe tradhtisë kanë shënuar një faqe të zezë në historinë e dy kombeve në mesin e shekullit XX.

Bota njeh në shekujt e saj të jetës së shumë vendeve mjaft masakra. Madje mjaft prej tyre të bëra ashtu me mjaft prej tyre edhe sot janë misterioze në disa tregues së tyre.

Përveç vlerave të saj historike, poema ka edhe mjaft vlera artistike. Të jep emocione të veçanta, qofshin këto të dhimbshme. Në të duhet të gjejnë të vërteta të pathëna të rinjtë, por ta rishikojnë veten edhe politikanët e shumtë të kombit tonë. Në poemë është zgjedhur strofa dyshe me një varg gati homerik ose më saktë i eposit të kreshnikëve.

Mjaft prej vargjeve kanë dhe harmoni të brendshme kjo te rrëfimi i poemës.

Në planin artistik të bie në sy pasthirrma dhe thirrori. Pas pasthirrmës "eh" që është shpërthyese në secilën strofë vjen edhe fjala "bir" që të kujton edhe piskamat e maleve të Kosovës që Ajet Shala i njeh fort mirë. I ka kënduar me qindra herë me tingullin e lahutës në vise të ndryshme.

Është një dialog rrëqethës që e mban këtë ritëm rrëfimi deri në vargun e fundit. Dhe nuk janë pak. Janë 303 njësi strofore me 2 424 vargje të tilla. Shpesh rrëfimi merr nota mjaft dramatike kur masakra futet në kufijtë e një tragjiciteti të jashtëzakonshëm.

Mbase edhe të rinjtë që mund të lexojnë këtë poemë duhet të kenë pak një udhërrëfyes më vete kur ta nisin e ta mbarojnë. Mbase edhe një libër shtojcë në mësimin e historisë, sidomos në Kosovë, mund të ishte ky libër. Vargjet ku të burgosurit vriten e bëhen copa-copa si në një thertore ose kur detyrohen ta qëllojnë njëri-tjetrin janë të paharruara. Në rrëfimin e babë Bajramit duket se marrim edhe mësimet e historisë së kombit tonë.

Pa dashur që të ndikojmë në shijet e lexuesve që do ta lexojnë këtë vepër, mendojmë se kjo është një arritje e mirë e poetit Ajet Shala. Ai ka plan që së shpejti të botojë edhe kujtime të drejtpërdrejta nga kjo masakër, për të cilat ka shumë vite që punon. Në mënyrë simbolike të duket se çdo lexues bëhet shoqërues, pjesë e marshimit nga më të egrit e historisë më fatkeqe, por që duheshin hedhur edhe në vargje.



# Si i shpenzojnë paratë të pasurit dhe super milionerët?



Çfarë e rrëmben vëmendjen e njerëzve më të pasur në botë? Kush janë ata? Dhe nga kanë ardhur të gjitha këto para?

Numri i individëve të pasur dhe pasuria e tyre kolektive u rrit me rreth 2% vitin e kaluar, sipas një raporti të ri nga Wealth-X, një kompani që gjurmon pasurinë globale. Ishin rreth 23 milionë individë me vlerë të lartë pasurie në botë në 2018-ën, me një vlerë të kombinuar neto prej 62 trilionë dollarësh.

Shumica janë të vetëpunësuar dhe jetojnë në Shtetet e Bashkuara, dhe përbëjnë 40% të popullsisë së pasur të botës.

Edhe midis të pasurve, ka kategori për ndarjen e pasurisë, ku e para është ajo me vlerën e lartë neto dhe pastaj vlera ultra e lartë neto. Wealth-X ndjek individë me vlerë të lartë neto ose njerëz që kanë asete neto midis 1 milion dhe 30 milion dollarë. Shumica janë të grupuar në pjesën e poshtme, me gati 90% të individëve me vlerë të lartë neto mes 1 milion dhe 5 milion dollarë.

Individë me vlerë shumë të lartë neto konsiderohen të jenë ata që kanë pasuri më shumë se 30 milionë dollarë.

## Por, për çfarë i shpenzojnë ata paratë e tyre?

Njerëzit më të pasur në botë dhurojnë shumë nga paratë e tyre. Filantropia është një nga qëllimet kryesore të të pasurve, veçanërisht në mesin e ultra të pasurve, me 36% të të pasurve dhe 57% të super të pasurve që ekspozojnë bamirësinë si një prej interesave të tyre më prioritare. Për shumicën e individëve me vlerë të lartë neto të pasurisë ky mision është një përparësi.

Pas një rënieje në prag të krizës globale financiare, filantropia ka rikuperuar terren në botën e të pasurve. Megjithatë, të pasurit ende japin shumë më pak se njerëzit me mjete më të kufizuara, sipas raportit.

Vitin e kaluar super të pasurit krijuan disa dhurata të profilit të lartë. Për shembull, Jeff dhe MacKenzie Bezos dhanë 2 miliardë dollarë për "Day One Found" për të ndihmuar të pastrehët dhe Michael Bloomberg dha 1,8 miliardë dollarë për "Johns Hopkins University", si ndihmë financiare.

Për super të pasurit e Amerikës, dhurimi i parave mund të ngadalësohet për shkak të shqetësimeve ekonomike dhe ndikimit të vendimit të 2017, "Tax Cuts dhe Jobs Act". Legjislacioni rriti zbritjen standarde. Kjo, nga ana tjetër, pritet të zvogëlojë numrin e deklaratave tatimore duke specifikuar zbritjet për dhuratat bamirëse nga rreth 37 milionë para se ligji të hyjë në fuqi në rreth 16 milionë në vitin 2018, sipas Qendrës së Politikave Tatimore.

Shkaqet më të njohura të bamirësisë në mesin e të pasurve vitin e kaluar përfshinin ata që mbështesnin arsimin, shërbimet sociale, artin dhe kulturën, por dhe shëndetin.

Por bamirësia është e dyta në biznes midis pasioneve, interesave dhe hobeve të më të pasurve në botë.

Pas filantropisë, të pasurit janë të interesuar për financat, pasuar nga sportet dhe nga udhëtimet, sipas Wealth-X.

Duke gërmuar më shumë në përditshmërinë e tyre, për të zbuluar se cilët nga sportet dhe aktivitetet preferojnë të pasurit, listën e kryeson golfi, i ndjekur nga futbolli, skitë, basketbolli dhe bejsbolli. Studiuesit vunë në dukje se këto sporte pasqyrojnë ndikimin që SHBA ka mbi popullsinë me pasuri të lartë në botë. Interesi për familjen, politikën, kafshët dhe gjuhët e huaja janë në fund të 20 vendeve të para.

## Kush janë njerëzit më të pasur?

Shumica e të pasurve janë ende burra. Vetëm 16% e individëve me vlerë të lartë neto pasurie janë femra. Në mesin e njerëzve super të pasur, vetëm 14% janë gra.

Pak më shumë se 40% e tyre jetojnë në Amerikën e Veriut, ndërsa një e katërta jetojnë në Evropë dhe një pjesë tjetër në Azi. Shtetet e Bashkuara kanë individët me vlerë më të lartë pasurie, të ndjekur nga Kina, Japonia, Gjermania dhe Mbretëria e Bashkuar.

Dhjetë vendet e para përbëjnë ¾ e popullsisë globale me vlerë të lartë neto pasurie, dhe vetëm nën ¾ e pasurisë së përgjithshme me vlerë të lartë në vitin 2018.

Qyteti i Nju Jorkut ka njerëzit më të pasur krahasuar me çdo qytet tjetër në botë, megjithëse numri është zvogëluar me rreth gjysmë përqind në 2018. Megjithatë, me vetëm nën një milion individë me vlerë të lartë neto, popullsia e pasur e Nju Jorkut është 65% më e madhe se e qytetit të dytë më të pasur, që është kryeqyteti japonez, Tokio.

Hong-Kongu ka popullsinë më të madhe të banorëve super (ultra) të pasur, duke u bërë qyteti i parë që ka më shumë se 10,000 individë shumë të pasur pas Nju Jorkut që dominoi vitin e kaluar.

Por popullsia me vlerë të lartë të pasurisë neto në Hong Kong ra me më shumë se 11% në 2018, pjesërisht si rezultat i tregjeve në Hong Kong dhe Kinë që reaguan negativisht ndaj pasigurisë tregtare midis SHBA dhe Kinës.

Lista me vendet që parashikohen të kenë rritjen më të madhe të individëve me vlerë të lartë neto pasurie në pesë vitet e ardhshme përfshijnë Nigerinë, Egjiptin, Bangladeshin dhe Vietnamin.

## Si i bënë paratë e tyre?

Sipas raportit, vetëm një përqindje e vogël e njerëzve më të pasur në botë trashëgoi të gjitha paratë. Shumica janë përgjegjës për krijimin e pasurisë në mënyrë autonome.

Gati 84% e individëve me vlerë të lartë pasurie kanë "ndryshuar" fatin e tyre. Vetëm rreth 5% kanë trashëguar plotësisht paratë e tyre dhe rreth 12% kanë një pasuri që kombinon pasurinë e trashëguar dhe të vetë-krijuar.

Një përqindje më e lartë e të pasurve kanë trashëguar pasurinë e tyre, me rreth 30% që kanë marrë një pjesë ose të gjithë pasurinë e tyre nga trashëgimia dhe 70% që e kanë krijuar pasurinë e tyre.

Raporti thekson se ndërkohë që pabarazia është rritur në dekadat e fundit, gjatë shekujve të fundit pasuria e trashëguar ka rënë dhe përqindja e individëve të pasur, fatet e të cilëve mbizotërojnë kryesisht nga zotësia personale, vazhdon të rritet.

Në mesin e industrive ku është përqendruar aktiviteti i më të pasurve, janë: Financa dhe biznesi; prodhimi; teknologjia; shërbimet e biznesit dhe ndërtimi./ Gazeta Shqip




Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | ARSENAL - CHELSEA | GG3+ | QPR - PRESTON | 1 | DONCASTER - BURTON ALBION | 1 |
|---|---|---|---|---|---|---|

# Kelmendi: Kosova mund të kalojë një raund

Bardh Kelmendi ka shprehur optimizëm se Përfaqësuesja e Kosovës në futsall mund ta kalojë rrethin e parë kualifikues në parakualifikimet për Kampionatin Botëror. "Besoj shumë në sukses, sepse selektori ka ftuar lojtarët e nivelit më të lartë të futsallit në Kosovë dhe jemi të bindur se mund ta kalojmë të paktën një raund", ka thënë Kelmendi

EPOKA E RE Veton ZYMBERI



PRISHTINË, 18 JANAR - Bardh Kelmendi ka marrë ftesë nga Përfaqësuesja e Kosovës në Futsall për ndeshjet parakualifikuese për Kampionatin Botëror "Lituania 2020". Lojtari i Besës, Bardh Kelmendi, ka thënë të premten për "Epokën e re" se ndihet krenar që i është dhënë mundësia për të kontribuar për skuadrën përfaqësuese. "Dy herë kam pasur ftesë të grumbullohem në përfaqësuese, por kjo është hera e parë që grumbullohem për parakualifikuset që mbahen në Bjellorusi. Ftesën e kam pritur mirë, si çdo lojtar që ka dëshirë ta përfaqësojë vetën në botëror, për çka ndihem shumë i privilegjuar që në përfaqësuese grumbullohen vetëm lojtarët që tregojnë rezultate të mëdha", ka thënë Kelmendi, i cili është shumë i kënaqur me formën personale që po tregon në muajt e fundit si në përfaqësuese, po ashtu edhe në klubet ku është angazhuar. "Kam pasur formë të mirë si në grumbullimin në përfaqësuese, po ashtu edhe në ekipin e Feniksit, ku kam luajtur dy lojë dhe në debutim shënova gol. Pas shuarjes së Feniksit kalova te Besa dhe në gjysmësezon zhvillova katër ndeshje dhe shënova gjashtë gola", ka deklaruar ai.
Lidhur me synimet që ka Kosova në këto parakualifikime, Kelmendi ka shprehur optimizëm se mund të kalohet rrethi i parë. "Besoj shumë në sukses, sepse selektori ka ftuar lojtarët e nivelit më të lartë të futsallit në Kosovë dhe jemi të bindur se mund ta kalojmë të paktën një raund", ka thënë Kelmendi. Skuadra e Besës në sezonin vjeshtor përfundoi në pozitën e tretë në Superligën e Kosovës në futsall, por Kelmendi beson se skuadra pejane mund të shpallet kampione. "Besoj shumë se Besa do të kthehet edhe më fuqishëm në stinorin pranveror, pasi në këtë skuadër ka lojtarë shumë cilësorë. Kemi besim se mund ta sjellim në Pejë titullin e kampionit. Ky klub dhe trajneri Adnan Hyseni e meritojnë një sukses të tillë", ka shtuar ai.
Përfaqësuesja e Kosovës në futsall është përfshirë në grupin 3 për parakualifikimet e Kampionatit Botëror 2020. Kosova u përfshi në grup me Norvegjinë, Bjellorusinë dhe Andorrën. Ky do të jetë cikli i parë kualifikues i Kosovës për Kampionatin Botëror. Ndeshjet parakualifikuese të grupit të tretë do të zhvillohen në Bjellorusi prej 29 janarit deri më 3 shkurt. Dy ekipet e para në secilin grup do të kalojnë në rrethin e ardhshëm kualifikues.

## SHKURT

### Shaqiri: Ja si fitohet titulli i Premierë Ligës

Lojtarët e Liverpoolit duhet ta ruajnë mentalitetin fitues nëse dëshirojnë suksesin në Premierë Ligë. Kështu ka thënë Xherdan Shaqiri, një nga transferimet më të mira të këtij sezoni në Premierë Ligë, ku për 12 milionë euro kaloi te Liverpooli nga skuadra e Stokes. "The Reds" janë rrugës së mirë për t'i dhënë fund pritjes së gjatë prej vitit 1990 pa një titull të fituar në Premierë Ligë. "Natyrisht, trajneri tenton ta largojë presionin nga lojtarët. Kjo është plotësisht normale, por nëse e sheh se ke mundësi të fitosh diçka, atëherë duhet ta përdorësh mentalitetin fitues edhe në fushë", ka thënë Shaqiri për faqen zyrtare të Liverpoolit. Shaqiri deri më tani ka regjistruar 22 paraqitje për Liverpoolin dhe 17 prej tyre janë vetëm në Premierë Ligë, ku ka shënuar edhe gola të rëndësishëm.

### Llapi - Gobleni, 8-0

Skuadra e Llapit e ka zhvilluar ndeshjen miqësore me skuadrën e Goblenit e cila bënë gara në Ligën e Dytë të Maqedonisë. Skuadra e drejtuar nga trajneri Xhengiz Rexhepi ka arritur fitore me shifrat 8-0. Golat i realizuan Ahmed Januzi, Festim Alidema, Miran Maksuti, Muhamet Hyseni, Lorik Aliu, Valmir Veliu (2) dhe një autogol. Llapi në këtë edicion lufton për titullin kampion në Kosovë së bashku me Prishtinën dhe Feronikelin.

### Federeri dhe Sharapova kualifikohen tutje në "Australian Open"

Roger Federeri është kualifikuar në mesin e 16 më të mirëve në "Australian Open", pasi e ka mposhtur lehtësisht 3-0 me sete (6-2, 7-5, 6-2) amerikanin Taylor Fritz në më pak se një orë e gjysmë lojë. Asnjë problem edhe për Rafael Nadalin. Numri 2 në botë triumfoi ndaj australianit Alex De Minaur, bartësit numër 27 i turneut, 3-0 me sete, 6-1, 6-2, 6-4, në dy orë e 24 minuta lojë. Në raundin tjetër spanjolli do të përplaset me çekun Tomas Berdych. Në konkurrencën e femrave, spikati fitorja e Maria Sharapovës ndaj Carolina Wozniackit 2-1 me sete (6-4, 4-6, 6-3). Petra Kvitova eliminoi Belinda Bençiq 6-1, 6-4, ndërsa Angelique Kerber kaloi pa probleme Kimberly Birrell 2-0 në sete 6-1 dhe 6-0.

## Presidenti Meta takon kampionët e xhudos nga Kosova

TIRANË, 18 JANAR - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, i ka takuar të premten xhudistët nga Kosova. Presidenti shqiptar ka thënë se këta sportistë janë motiv krenarie dhe model suksesi e frymëzimi për fëmijët e të gjithë të rinjtë shqiptarë. "Një takim i ngrohtë me krenarinë e sportit shqiptar, Majlinda Kelmendi dhe kampionët e xhudos nga Kosova, Shpat Zeka, Erza Muminoviq e Akil Gjakova dhe trajnerin e tyre të mirënjohur Driton Kuka, ambasadorët e shkëlqyer të vlerave më të mira njerëzore e sportive të kombit shqiptar në botë. Iu urova shumë suksese në stërvitjen që kanë nisur për Lojërat Olimpike 'Tokyo 2020', besimplotë se do të arrijnë të ngrenë lart flamurin e Kosovës. Majlinda, Distria, Nora, Erza, Akili, Shpati e shumë sportistë të tjerë janë motiv krenarie dhe model suksesi e frymëzimi për fëmijët e të gjithë të rinjtë shqiptarë", ka shkruar presidenti Meta në "Facebook".



## U16-shat marrin pjesë në turneun e Dubait



PRISHTINË, 18 JANAR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll për grupmoshën deri 16 vjeç do të marrë pjesë në turneun ndërkombëtar në Dubai, i cili mbahet prej 8 deri më 15 shkurt. Sipas drejtorit për marrëdhënie me jashtë dhe të ekipeve përfaqësuese, Artan Govori, ftesa për pjesëmarrje në këtë turne ka ardhur nga Federata e Emirateve të Bashkuara Arabe, kurse krahas Kosovës dhe kombëtares nikoqire në grup do të jenë edhe Belgjika dhe Republika e Çekisë. "Të gjitha shpenzimet e akomodimit në Dubai do t'i mbulojë Federata e UAE-së, kurse FFK-ja do t'i mbulojë shpenzimet e udhëtimit. Turne të tilla pa dyshim se janë të mirëseardhura dhe ndikojnë në zhvillimin e mëtejmë të ekipeve zinxhirore të kombëtareve, prandaj FFK-ja është e përkushtuar që në vazhdimësi t'u mundësojë ekipeve përfaqësuese aktivitete edhe jashtë kalendarit të garave zyrtare", thuhet në njoftimin e Federatës së Futbollit të Kosovës.

# Sot fillon stinori pranveror



PRISHTINË, 18 JANAR - Të shtunën me përballjen në mes të Lipjanit dhe Ponte Prizrenit që do të zhvillohet në Lipjan me fillim nga 17:00 do të nisë stinori pranveror në Superligën e Kosovës në basketboll. Risi e këtij ndeshje është fakti se skuadra e Lipjanit do të luajë për herë të parë në Superligë si nikoqir në palestrën e saj, pasi që Federata e Basketbollit të Kosovës së fundi ia ka miratuar palestrën, pas investimeve të fundit që i ka bërë Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Komuna e Lipjanit në këtë palestër. Ndërkaq të dielën janë në program tri ndeshje në kuadër të xhiros së XV-të, ku Z Mobile Prishtina e pret Trepçën me fillim nga ora 16:00 në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë, derisa Bashkimi e pret Golden Egale Yllin duke filluar nga 17:00 në Palestrën "Sezai Surroi" në Prizren, kurse Borea është nikoqire e Rahovecit, takim ky që luhet në palestrën "Karagaçi" në Pejë duke filluar nga ora 19:00.

# Lakersat triumfojnë pas kohës shtesë, Denveri dhe Toronto bëjnë detyrën



OKLAHOMA, 18 JANAR - Pas një loje spektakolare dhe pesë minutave shtesë, skuadra e LA Lakers fitoi 138-128 ndaj Oklahomës në fushën e këtij të fundit. Një takim që dhuroi shumë emocione, me Lakersin që triumfoi edhe pse në fushën e një ekipi pretendent për titull dhe pa LeBron Jamesin. George me 27 pikë e Westbrooku me 26 pikë e 13 asistime ishin më të mirët për skuadrën e Thunderit, por të pamjaftueshëm për ta evituar humbjen. Në kahun tjetër, Kuzma me 32 pikë e Subaqi me 26 pikë e 12 rebounde u dalluan në parket për Lakersin, ndërkohë që 61 pikë për kalifornianët u dalluan nga lojtarët e stolit. Rikthehet te fitorja skuadra e Torontos, që mundi 111-109 Phoenixin, sfidë që u bë tejet dramatike në fund. Ibaka realizoi 22 pikë, duke qenë shënuesi më i mirë për kanadezët, ndërsa 30 pikët e Bookerit për miqtë mbetën për statistikë. Në ndeshjet e tjera, Philadelphia mposhti me lehtësi 120-96 Indianan në fushën e këtij të fundit, sfidë e dominuar nga miqtë. Butleri e mbylli me 27 pikë, mbështetur edhe nga Embiidi me 22 pikë e 13 asistime. Charlotte, falë 23 pikëve të Walkerit, mundi 114-95 Sacramenton, sukses i merituar për Bobcatsin, ndërsa Denveri konsolidon vendin e dytë në Perëndim pas fitores 135-105 ndaj Chicagos (Murray 25 pikë).

**REZULTATET**

| | |
|---|---|
| Charlotte - Sacramento | 114-95 |
| Indiana - Philadelphia | 96-120 |
| Toronto - Phoenix | 111-109 |
| Denver - Chicago | 135-105 |
| Oklahoma - Lakers | 128-138 |

## SHKURT

### Mourinho: Interi, skuadra më e mirë që kam drejtuar

Historia e Jose Mourinhos me Interin duket se karakterizohet nga një dashuri reciproke, që nuk do të përfundojë kurrë. Portugezi drejtoi zikaltrit në periudhën 2008-2010, ndërsa në sezonin e dytë dhe të fundit në Milano fitoi gjithçka, pra tripletën e famshme, me të cilën Interi krenohet edhe sot, ndërsa Mourinho zgjodhi pikërisht skuadrën milaneze, si më të mirën që ka drejtuar. "Interi ka qenë skuadra më e mirë që kam drejtuar, pasi kemi bërë një sezon fantastik, duke fituar gjithçka. Kemi qenë të pamposhtur dhe kemi eliminuar në Ligën e Kampionëve, skuadrën më të mirë të botës atëherë, Barcelonën", ka thënë Mourinho.

### Ja shtatë lojtarët që do të largohen nga Reali

Real Madridi po regjistron rezultate të dobëta në La Liga. "Madrilenët" gjatë verës kanë humbur shërbimet e Cristiano Ronaldos, por duket se në verën që vjen do të ketë largime të shumta nga "Santiago Bernabeu". E përditshmja sportive spanjolle, "Marca", raporton se në listën e shitjes janë edhe shtatë lojtarë të tjerë: Gareth Bale, Luka Modriq, Marcelo, Jesus Vallejo, Mariano Diaz, Isco dhe portieri Keylor Navas.

### Piatek nuk shkon në Angli, shkak Milani

Sulmuesi Krztysztof Piatek është ndër lojtarët më të kërkuar në këtë afat kalimtar. West Ham Unitedi bëri dy oferta zyrtare në drejtim të tij, por sulmuesi në fjalë i refuzoi për faktin se dëshiron të mbetet pesë e futbollit italian. Milani është skuadra e interesuar dhe afër marrëveshjes me sulmuesin polak. Më herët është raportuar se Piatekun e duan edhe Juventusi dhe Napoli në Itali dhe Real Madridi në Spanjë.

### Lojtarët e Unitedit e duan Solskjaerin trajner të përhershëm

Që nga largimi i menaxherit Jose Mourinho, skuadra angleze Manchester United ka arritur t'i fitojë gjashtë ndeshje. Për këtë arsye futbollistët e Unitedit, e duan norvegjezin Ole Gunnar Solskjaer si menaxher të përhershëm, shkruan "Goal". Përveç rezultateve të mira gjatë ndeshjeve, stafi i kësaj skuadre është i kënaqur me metodat dhe personalitetin e menaxherit norvegjez, dhe për këtë arsye dëshiron që ai të mbetet pjesë e klubit.

### Skriniari nuk largohet nga Interi

Mbrojtësi Milan Skriniar nuk pritet të largohet nga Interi. "Tuttosport" raporton se Skriniar ka arritur marrëveshje në parim për zgjatjen e kontratës me skuadrën e Interit deri në vitin 2023. Me kontratën e re, 23 vjeçari do të gëzojë një rritje page, duke shkuar deri në afër tre milionë euro.

### Mandzukiqi refuzoi një superofertë nga Kina

Mario Mandzukiq po vazhdon fazën rehabilituese dhe pritet që të kthehet në fund të muajit në dispozicion të trajnerit Massimiliano Allegri. Ndërsa klubi i Juventusit dhe drejtuesit po përgatisin edhe rinovimin e kontratës për kroatin, e cila pritet të ketë vlefshmëri deri më 2022, nga Kina ka mbërritur një ofertë faraonike për nënkampionin e botës. Klubi i interesuar për shërbimet e Massimiliano Allegrit është Shangai SIPG, të cilët i kanë ofruar 16 milionë euro neto si pagë për tri sezonet e ardhshme, por burime pranë futbollistit, përveçse pranojnë ofertën, nënvizojnë gjithashtu se numri 17 i Juventusit e ka refuzuar atë pa u tunduar aspak.



**Autor: GAZMEND MORINA**

AKTORI AMERIKAN STILLER

JURIST QË JEP NDIHMË E KËSHILLA PËR ÇËSHTJE TË DREJTËSISË

JEVG

IVAN KLASNIÇ

KËNGËTARJA ANGLEZE TANITA

KRYENGRITËSI QË DILTE MALIT E LUFTONTE / MINDERI I ULËT (vjet.)

IVREA

EPOKA E RE

BIMË SHUMËVJEÇARE ME TRUNG TË TRASHË

LLOJ BIME NARKOTIKE

ZËRI I BURRIT NDËRMJET TENORIT DHE BASIT

DY BASHKËTINGËLLORE / DRAMË E SANTORIT

NGJALLJA E KUJTIMEVE PËR DIKË

EPOKË (shq.)

KANUN, LIGJ (vjet.)

AKTROJA AMERIKANE BASINGER / SHTET I MADH NË AZI

SEKRETARI I OKB-së BAN KI / QË ËSHTË LARA-LARA NË TRUP (për kafshët)

EPOKA E RE

BASHKËT. SHPREHET ME FJALË

GJAKATARI / BIXHOZ

ZANORE / MALI MË I LARTË NË TURQI

NJERI I VARFËR QË ËSHTË PËR T'U MËSHIRUAR (shq.)

BANORI I ARABISË SAUDITE / VARGU I KURANIT

BUJKU / KËNGËTARJA BERISHA

KËNGËTARJA ...... SEJDIU / ZANORE

NËNA / VEPRIMTARI ZEZAK MARTIN ..... KING

ANTIGONA SEJDIU / OLIVIER MARTINEZ

EPOKA E RE

DIÇKA QË BURON NGA DIÇKA TJETËR

I SPËRKATA ME UJË

BOKSIERI I NJOHUR KLITSCHKO

"Z" në mes të dy "A"

PAKTI USHTARAK MË I MADH NË BOTË

TEXAS LIBRARY ASSOCIATION / IDRIZ BALAJ

REGJISORI ... QOSJA

TËRËSIA E ORENDIVE / SMIRA

KANAPE E GJERË DHE E GJATË SI SHTRAT (shq.)

PËRGËZIMET / SHTET (FR.)

MIMOZA AHMETI / AKTORJA ....... AJETI

AKTORJA ME FAMË BOTËRORE ... FARIS

AKTORJA E FAMSHME AMERIKANE NË FOTO ........ OLSEN (shqip.)

KËNGËTARI ..... ARIFI / ENË E METALTË PËR TË SKUQUR VAJIN

TONI ADAMS / QYTET I SHENJTË I MYSLIMANËVE

KËSTET BANKARE PËR KTHIMIN E KREDISË

GRADË USHTARAKE / QË KA TË BËJË ME FSHATIN

REGJISORI .... HALILI / PUNËTOR I TEATRIT TË KUKULLAVE

KOHA E NDARË PËR PUNË / POLITIKANI FERID .....

JETËSHKRIM / ISH FUTBOLLISTI ANGLEZ SHEARER (origj.)

ARMENIA UNITED PROGRESIVE ALLIANCE

SHIU I IMËT / DALLGA

UMA TURMAN / AKTORI EGJIPTIAN .... SHARIF

BISHTUK ME VAJGURI (shq.) / QË KA MBUSHUR NJË VIT, MOTAK

PRAPË

ARTANA

ISH MUZIKANTI RUS STRAVINSKI / GDHENDUR, LATUAR

PYLLI / PIKA MË E LARTË NË KUPËN E QIELLIT (pashq.)

I ÇELA / ISH AKTORJA AMERIKANE GARDNER

DY BASHKËTINGËLLORE

FEMRA LUFTËTARE QË NUK MARTOHEJ (mit. greke) / POROSIA E FUNDIT

MA JEP / INSTITUCION I LARTTË SHKENCOR

AGIM POSHKA / KALI I SHALËS

EPOKA E RE

HENDEK PËR TË UJITUR (sh.shq.) / LLOJ SHALE DRURI

ANIJATA / HARAÇ

ZANORE / ALBANOLOGIA DURHAM

FUTBOLLISTI FRANCEZ ..... NASRI (MANCHESTER CITY)

SHEGË / LUMË NË SHQIPËRI

BRINJËT QË FORMOJNË KËNDIN E DREJTË TË TREKËNDËSHIT / SHEJTAN

ALUMIN, AMPER

KLUB FUTBOLLI NË GREQI

PAJISJA E VETURËS SË LËSHON TINGUJ / REOMIR, INDIUM

OSAKA / RROGË VJETORE E PAPËS

IVAN DIXON / QË I PËRKET ETIKËS

BALTA E QULLËT, GJANA

KULLË E XHAMISË

SHKRIMTARI ISMAIL / STUDENT AID REPORT

IGLESIAS GABRIEL / NJËSI E VJETËR PESHE

ZBRITJE E AEROPLANIT NË TOKË

ELEMENT KIMIK (SE)

FUTBOLLISTI FRANÇESKO (ROMA) / TITAN

PUNA E PËRDITSHME, ZAKONISHT E MËRZITSHME, PA ASNJË NDRYSHIM

ATEMOR, JO TEMATIK / ZANORE

BASHKËT. / KRUJA

REGJISORJA .... ELEZI

HIJESHI, BUKURI QË TË BËN PËR VETE

LIQEN I MADH NË AMERIKËN JUGORE

*Republika e Kosovës*
*Republika Kosova - Republic of Kosovo*
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health*
*Sherbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosoves*
*Hospital and University Clinical Service of Kosova*
*Universitetske Bolnicke Klinicke Sluzbe Kosova*
*Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës – Univerzitetski Stomatološki Klinički Centar*
*Kosova – University Dentistry Clinical Center of Kosovo*

QKSUK

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212,dispozitave të nenit 4. dhe neni 5 të Udhëzimit(MPMS)Nr. 07/2017 Administrativ për Rregullimin e Procedurave të Konkursit për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik, nenit 15 dhe 21 të Statutit, Rregullorës mbi Organizimin, Sistematizimin e vendeve te punës dhe në bazë të vendimit të Këshillit Drejtues të datës 09.01.2019. QKSUK shpall :

# K o n k u r s
## për plotësimin e vendit të lira të punës

**Titulli i punës:** Asistent/e e Drejtorit Ekzekutiv (1 pozitë),
Nr. ref. 001/2019-QKSUK
**Njësia:** Departamenti i Administratës Qendrore
**Orari i punës:** Normë e plotë
**Koeficienti:** 6.00
**Nëpunësi mbikëqyrës:** Drejtori Ekzekutiv
**Kohëzgjatja e Kontratës:** Kohë të pacaktuar

**Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:**
1. Formulon kornizën e punës administrative-teknike;
2. Aranzhon mbledhjet, pranon palët, i drejton dhe organizon thirrjet telefonike, u përgjigjet kërkesave për informata të rëndomta, dhe ndihmon përgatitjet për udhëtim të eprorit;
3. Nën udhëzimin e eprorit përpilon dhe shkruan drafte të dokumenteve;
4. Pranon dhe evidenton postën;
5. Mban evidencën zyrtare dhe arkivin e dokumenteve të zyrës, në mënyrën e cila siguron orientim dhe referim të lehtë si dhe besueshmëri të plotë të ruajtjes së të gjithë dokumentacionit dhe informacionit;
6. Me kërkesë të eprorit, merr pjesë në mbledhjet, mban shënime nga mbledhja, përpilon dhe shpërndan procesverbale, dhe sipas nevojës përkthen materiale;
7. Menaxhon në mënyrë efektive me punët teknike dhe administrative, duke siguruar funksionalitet të plotë të zyrës së Drejtorit Ekzekutiv të QKSUK -së;
8. Kryen detyra të tjera në bazë të kërkesës;

**Kualifikimi:**
Përgatitja: Shkolla e Mesme,

**Përvoja:** Së paku një vjet përvojë pune

**Aftësitë:**
Themelimi i marrëdhënieve të mira ndërpersonale.
Njohja e gjuhëve zyrtare, në përdorim.
Aftësitë e mira të komunikimit.
Gatishmëria për të vepruar në mënyrë të pavarur dhe me pak mbikëqyrje.
Njohja e mire e punës me kompjuter (Microsoft Word dhe Excel).
Njohja e gjuhës angleze si dhe trajnimet e ndryshme nga administrata paraqesin përparësi.

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:** Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësi për kryerjen e detyrave të punës, perparsi kanë kandidatët me pergatitje të lartë arsimor me fakultet.

**Procedurat e konkurrimit:** Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga data e publikimit në mjetet e informimit,

**Paraqitja e kërkesave:** Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën e personelit të QKSUK-së. Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës.

*Republika e Kosovës*
*Republika Kosova - Republic of Kosovo*
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health*
*Sherbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosoves*
*Hospital and University Clinical Service of Kosova*
*Universitetske Bolnicke Klinicke Sluzbe Kosova*
*Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës – Univerzitetski Stomatološki Klinički Centar*
*Kosova – University Dentistry Clinical Center of Kosovo*

QKSUK

Na osnovu člana 8 Zakona o radu br. 03 / L-212, odredbe člana 4. i člana 5. Uputstva (MRSZ) br. 07/2017 Upravni postupak za regulisanje javnih ugovora za utvrdvanje odnosa sa javnošću, čl. 15. i 21. Statuta, Pravilnik o organizaciji, sistematizaciji radnih mjesta i Odluka Upravnog odbora od 09.01.2019. SKUCK objavljuje :

# K o n k u r s

**Naziv posla:** Asistent Izvršnog Direktora (1 pozicija)
Br. Ref. 001/ 2019- SKUCK
**Jedinica:** Odeljenje centralne administracije
**Radno vrijeme:** 40 nedeljno
**Koeficijenti:** 6.00
**Nadzorni službenik:** Izvršni direktor
**Trajanje ugovora:** neodređeno

**Glavne dužnosti i odgovornosti:**
1. Formulisanje administrativno-tehničkog okvira;
2. Organizovati sastanke, prihvatiti stranke, upravljati i organizovati telefonske pozive, odgovarati na zahtjeve za zajedničkim informacijama i pomoći u pripremi putovanja nadređenog;
3. Pod vodstvom nadređenog sastavlja i piše nacrte dokumenata;
4. Prihvata i snima poštu;
5. Čuva službene evidencije i arhive kancelarijskih dokumenata na način koji omogućava laku orijentaciju i upućivanje, kao i potpunu poverljivost čuvanja sve dokumentacije i informacija;
6. Na zahtev nadređenog, učestvuje na sastancima, vodi evidenciju o sastanku, sastavlja i distribuira zapisnike, i, po potrebi, prevodi materijal;
7. Efikasno pravlja tehničkim i administrativnim radom, osiguravajući punu funkcionalnost izvršnog direktora SKUCK.
8. **Obavlja i druge poslove na zahtjev;**

**Priprema:** Srednja škola.

**Iskustvo:** Najmanje godinu dana radnog iskustva.

**veštine:** Uspostavljanje dobrih međuljudskih odnosa. Poznavanje službenih jezika u upotrebi. Dobre komunikacijske vještine. Spremnost da deluju nezavisno i sa malo nadzora. Dobro poznavanje rada na računaru (Microsoft Vord i Ekcel). Poznavanje engleskog jezika, kao i različiti treninzi iz administracije su prioritet.

**Uslovi za učešće u zapošljavanju**: Svi državljani Republike Kosova odraslog uzrasta koji imaju sposobnost da djeluju, imaju završeno obrazovanje i imaju vještine za obavljanje svojih dužnosti imaju pravo da se prijave. prioritet, postoje kandidati sa visokom stručnom spremom - fakultet.

**Procedure konkurencije:** Konkurs je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja u medijima,

**Podnošenje prijava:** Prijave se primaju i dostavljaju u kancelariju osoblja SKUCK
U prijavi treba jasno navesti naziv posla i referentni broj.

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo

## Njoftim për tatimpagues

## ATK, modifikon formularët tatimor PD dhe CD

Administrata Tatimore e Kosovës, ju njofton se Formulari i deklarimit vjetor dhe pagesës për Tatimin në të Ardhurat Personale (PD) dhe Formulari i deklarimit vjetor dhe pagesës për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave (CD), janë duke u modifikuar, Andaj deri më 25 janar 2019, nuk mundësohet dorëzimi i këtyre formularëve.

**Publikimi i formularëve të modifikuar do të bëhet më 25.01.2019 dhe të gjithë tatimpaguesit nga kjo datë e tutje mund të deklarojnë dhe të paguajnë përmes këtyre formularëve.**

**Administrata Tatimore e Kosovës**

BKS
BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT
KOSOVSKI URED OSIGURANJA
KOSOVO INSURANCE BUREAU

## *** FTESË PËR OFERTË ***

Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) është organizatë profesionale me cilësinë e personit juridik e themeluar për qëllime jofitimprurëse. Duke qenë se, në kuadër të Byrosë Kosovare të Sigurimit funksionon Qendra Informative e Sigurimit, Sigurimi Kufitar dhe të tjera, BKS i fton të gjithë të interesuarit të paraqesin ofertat mbi tenderin si më poshtë;

**"Shtypja e policës TPL, TPL+ dhe policës të Sigurimit Kufitar për Byronë Kosovare të Sigurimit dhe Industrinë e Sigurimit".**

Kushtet për ofertim;

- Oferta financiare,
- Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrimin e biznesit dhe TVSH-së,
- Eksperienca e ofertuesit me punë të ngjashme (së paku dy vitet e fundit),
- Garancioni për shërbimin e ofruar, si dhe
- Kushtet tjera të përcaktuara në dosjen e këtij tenderi.

Oferta duhet të paraqitet brenda datës dhe orës së mëposhtme:
**25 Janar 2018, ora 13:00 – 14:00**
Me zarf të mbyllur, në kopje të printuar dhe jo nëpërmes e-mailit, tek:
**Byroja Kosovare e Sigurimit**
**Rr. Lidhja e Pejës pn/ Magjistralja Prishtinë – Fushë Kosovë**

Poashtu,

**Dosjen e tenderit mund ta kërkoni përmes e-mailit:** bks@bks-ks.org

Ju falënderojmë sinqerisht për interesimin që tregoni për të bashkëpunuar me Byronë Kosovare të Sigurimit dhe mbesim me shpresë se do t'i respektoni të gjitha kërkesat si më sipër të paraqitura nga ana jonë.

MILLENNIUM FOUNDATION KOSOVO

**REPUBLIC OF KOSOVO**

**MILLENNIUM FOUNDATION KOSOVO**

**PROCUREMENT NOTICE**

**ADDENDUM FOR THE EXTENSION OF DEADLINE FOR SUBMISSION OF PROPOSALS**

A Specific Procurement Notice for *"Procurement of Implementer for Pilot Incentives for Energy Efficiency"* with Procurement Reference: *RFP / MFK /2018/ QCBS / No. 020,* was published on 10 December 2018 in dgMarket, UNDB Online, local newspapers, and MFK website.

In accordance with Section I, ITC Clause 9 of the Request for Proposal, based in bidders requests the MFK has taken a decision to extend the proposal submission date.

It is notified that the dates for receiving and opening of the proposals has been extended as follows:

Proposals must be submitted no later than 14:00 hours p.m. (CET time), on 14 February 2019.

The Opening of proposals: 14 February 2019, 14:30 hours p.m. (CET time).

Responses to the clarification's requests will be issued to all Consultants not later than 23 January 2019.

Millennium Foundation of Kosovo
Address: Str. "Migjeni" no.21 (ex-Bank of Ljubljana Building, floor IX),
Postal Code:10000 Prishtina, Kosova
Email: procurement@millenniumkosovo.org
Phone Number: 00 383 38 752 110

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Supersport" Sh.P.K. me seli në Gllogoc, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: NRB. Biznesit 810041947 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavještavamo se svi klienti da Tvrtka "Supersport" SH.P.K. u Gllogovc, doneo odluku da ugasi biznis po br.registra: 810041947, I ujdno imenovao Likfidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se sci klienti imaju obaveze I potrazivanja u navedenjo firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Company "Supersport " L.L.C in Gllogovc, has come to the decision to quit its business with registry: 810041947, The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager-mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement publication.

GJIMNAZI "XHEVDET DODA"
Prishtinë, 20.12.2018
Nr.P.528

## RISHPALLJE:

Në mbështetje të Rregullorës së Kuvendit të Komunës së Prishtinës -01.Nr.110-157460, të dt.01.07.2014, për të hyrat vetanake të institucioneve arsimore Neni 2, paragrafi 2.1 shkronja f dhe neni 6. Këshilli Drejtues i Shkollës me 03.09.2018 mori vendim (pika IV e vendimit) për dhënjen e hapësirës shkollore me qira, për hapjen e një Kantine për nxënës dhemësimdhënës. Kerkojmë Operatorë ekonomik që ofrojnë kushtet më të favorshme që do t'i vlerësoj komisioni.

Ofertat dorëzohen në administraten e shkollës në Gjimnazin "XhevdetDoda" në Prishtinë, brenda 7 ditëve nga dita e ri-shpalljes në shtypin ditor.

Këshilli Drejtues i Shkollës.

Rruga: "XhevdetDoda" Nr.60, Prishtinë - Kosovë
E-mail: shml.xhevdet.doda@rks-gov.net
Nr.tel: +383 (0) 38 613444

Njëzet vite pa më të dashurin tonë



# AFRIM (SINAN) HAJRIZI

(01.02.1965 - 20.01.1999)

Njëzet janari i vitit 1999, është një ditë shumë e veçantë për ne dhe për të gjithë kombin tonë. E përkujtojmë djalin, vëllain e prindin tonë të ndjerë Afrim Hajrizi i cili dha jetën e tij që ne, ta gëzojmë lirinë ku e jetojmë edhe sot.
**Më mall të pashuar e kujtojnë: nëna Zyla,vëllai Zeneli, djali Artani, Qemaili, Keqa, Gazmendi dhe Labinoti si dhe mbesat dhe nipërit që jetojnë në diaspora.**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Skenderajt
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**Drejtoria për Arsim** / Department of Education

Nr.prot. 642/2019
Datë: 18 janar 2019

## NJOFTIM

ANULOHET konkursi i datës 18.01.2019 me nr. protokolli 639/2019, me titull të vendit të punës : **Drejtor i shkollës fillore e të mesme të ulët (shfmu) dhe mesme të lartë (shml)** për plotësimin e 13 vendeve të lira të punës. Kjo bëhet për arsye të kërkesës që duhet bërë në MAP për zhvillimin e procedurave të konkursit nga ana e DKA dhe pas aprovimit nga MAP do të shpallet konkursi për drejtorë të shkollave fillore , të mesme të ulëta dhe të mesme të larta.

Drejtori i DKA-së
Bekim Latifi

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Ahmet (Avdulla) Selmani shpallë të pavlefshme dëftesat e vitit të I dhe të II, të shkollës së mesme Teknike Prishtinë.

▶ "Vorego" SH.P.K. shpallë të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 930016502.

▶ N.N.T. "Dekorativ" shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 601045166 me pronar Naser Halimi, Vushtrri.

▶ Naser Asllani shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Fehmi Rama" Likovc.

▶ Mufail Hoxha shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Fehmi Rama" Likovc

▶ Musa Kuliqi shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Fehmi Rama" Likovc

▶ Urgjentisht kërkoj një lokal me qira për Fast Food. Hapësira deri 70m2. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel 045/660-188

▶ Unë Fahri Avdiu distancohem nga djali im Bledi Fahri Avdiu dhe nuk marr asnjë përgjegjësi dhe asnjë obligim për veprat e tija, si borgje, vjedhje apo marrje të parasë me fajde. Si dhe njëkohësisht kërkoj nga ju të dëmtuarit që mos të më kontaktoni as në telefonin tim. Me respekt Fahri Avdiu.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

▶ Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi52 000€. Për info 044/672-439.

▶ Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.

▶ Shes banesën hyrja e 7 mbi kurriz te banesat e gjelbërta përball shkollës "Xhemajl Mustafa" e rinovuar tërësisht. Banesa ka 82 metra katror. 3 dhoma, sallon, shpajz dhe ballkon + taras me shfrytëzim. Çmimi 75000 Euro me para te gatshme, por bej edhe ndërrim me banesë me të vogël në Prishtinë ose banesë më të madhe në Fushë Kosovë sipas marrëveshjes. Numri kontaktues: 044 672 439

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.


AUTOSHKOLLA
“RITMO – L”
Auto Shkolla
“RITMO - L”
Prishtinë
Eksperienca jonë - përfitimi i juaj.
Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "
Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola